



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi-Skupština-Assembly

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORTI 2018
KOMUNAL
I VETËVLERËSIMIT

Mohim i përgjegjesisë: Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë dhe të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Ky publikim nuk ka të drejta autoriale, prandaj përmbajtja e tij mund të përdoret pjesërisht ose plotësisht pa lejen paraprake të UNDP-së në Kosovë. Megjithatë, burimi i tij duhet të citohet.

PËRMBAJTJA

Akronimet	5
Parathënia	6
Përmbledhja ekzekutive	7
1. Hyrja	9
2. Metodologjia e përgjithshme	11
2.1. Metodologjia e anketës	11
Puna në terren	12
Përpunimi i të dhënave dhe sigurimi i cilësisë	12
2.2. Metodologjia e Fokus Grupeve	14
3. Gjetjet kryesore	15
3.1. Administrata dhe Personeli	15
3.2. Buxheti dhe Financat	19
3.3. Bujqësia	23
3.4. Urbanizmi	25
3.5. Të drejtat e njeriut	28
3.6. Prokurimi komunal	29
3.7. Arsimi	31
3.8. Shërbimet publike	34
3.9. Shëndetësia dhe Mirëqenia sociale	39
3.10. Kultura, Rinia, dhe Sportet	41
3.11. Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi	42
3.12. Integrimi Evropian	44
4. Përfundimi dhe rekomandimet e përgjithshme	46
Shtojcat	55

TABELAT

TABELA 1:	Shpërndarja e intervistave nga përfaqësuesit komunalë	12
TABELA 2:	Struktura e treguesve dhe nën-treguesve	13
TABELA 3:	Treguesi i administratës dhe personelit, vetëm përgjigjet më të vlerësuara (%)	17
TABELA 4:	Buxheti dhe Financat, përgjigjet më të vlerësuara (%)	20
TABELA 5:	Bujqësia, përgjigjet më të vlerësuara (%)	24
TABELA 6:	Urbanizmi, vetëm përgjigjet më të vlerësuara (%)	27
TABELA 7:	Të drejtat e njeriut, vetëm përgjigjet më të vlerësuara (%)	29
TABELA 8:	Prokurimi komunal, vetëm përgjigjet më të larta (%)	31
TABELA 9:	Arsimi, vetëm përgjigjet më të vlerësuara (%)	33
TABELA 10:	Uji, kanalizimi dhe mbeturinat, vetëm përgjigjet më të vlerësuara (%)	36
TABELA 11:	Shëndeti dhe Mirëqenia sociale, vetëm përgjigjet më të vlerësuara (%)	40
TABELA 12:	Kultura, Rinia dhe Sportet, vetëm përgjigjet më të vlerësuara (%)	42
TABELA 13:	Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi, vetëm përgjigjet më të vlerësuara (%)	44
TABELA 14:	Integrimi Evropian, vetëm përgjigjet më të vlerësuara (%)	45

FIGURAT

FIGURA 1:	Treguesi i administratës dhe personelit dhe nën-treguesit e tij	15
FIGURA 2:	Treguesi i buxhetit dhe financave dhe nën-treguesit e tij	19
FIGURA 3:	Treguesi i bujqësisë dhe nën-treguesit e tij	23
FIGURA 4:	Treguesi i urbanizmit dhe nën-treguesit e tij	25
FIGURA 5:	Treguesi i të drejtave të njeriut dhe nën-treguesit e tij	28
FIGURA 6:	Treguesi i prokurimit komunal dhe nën-treguesit e tij	30
FIGURA 7:	Treguesi i arsimit dhe nën-treguesit e tij	31
FIGURA 8:	Treguesi i shërbimeve publike dhe emergjente dhe nën-treguesit e tij	34
FIGURA 9:	Treguesi i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe nën-treguesit e tij	39
FIGURA 10:	Treguesi i KRS-së dhe nën-treguesit e tij	41
FIGURA 11:	Treguesi i zhvillimit ekonomik dhe turizmit dhe nën-treguesit e tij	43

AKRONIMET

AZHB	Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
AME	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
OShC	Organizatat e Shoqërisë Civile
QPS	Qendrat për Punë Sociale
PDRr	Planet e Detajuara Rregullative
EMA	Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave
BE	Bashkimi Evropian
FG	Fokus Grupi
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
PZhK	Planet Zhvillimore të Komunës
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
NPK	Ndërmarrjet e Pavarura Komunale
MAPL	Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MAP	Ministria e Administratës Publike
KShA	Korniza e Shpenzimeve Afatmesme
HKNZ	Hartat Komunale të Ndarjeve Zonale
OJQ	Organizatë Joqeveritare
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

PARATHËNIA

Të nderuar kolegë,

Kemi bërë shumë progres në zhvillimin dhe avancimin e sistemit të qeverisjes lokale që nga koha kur Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për Vetëqeverisje Lokale në vitin 2008. Përpjekja jonë e përbashkët ka kontribuar në krijimin e strukturave të qëndrueshme komunale, forcimin e kapaciteteve të komunave dhe e ka përmirësuar qasjen e qytetarëve në shërbime.

Ne duhet ta ndërtojmë dhe ta mbështesim këtë progres dhe ta synojmë përsosmërinë. Në këtë mënyrë, Plani Strategjik për Vetëqeverisjen Lokale 2016-2026 e parashikon forcimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave si njëri prej objektivave tona kryesore strategjike. Kemi nevojë t'i avancojmë më tej kapacitetet e organeve komunale në adresimin e nevojave të qytetarëve në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Ky raport u zhvillua nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ai e ofron një pasqyrë të kapaciteteve komunale në ushtrimin e detyrave të punës në kuadër të obligimeve të tyre. Gjetjet e këtij raporti bazohen në kontributin e përfaqësuesve komunalë nga secila komunë, të cilët ofruan njohuri të thella mbi kapacitetet dhe nevojat e prioritetet për zhvillimin organizativ. Le t'i përdorim gjetjet e këtij raporti si një udhëzues për t'i përmirësuar më tej kapacitetet e komunave në realizimin e detyrave të punës në kuadër të obligimeve të tyre.

Në këtë mënyrë, shpresohet se gjetjet në këtë raport do të përdoren prej të gjithë akterëve institucionalë, duke i përfshirë edhe partnerët dhe palët e interesit, për t'i adresuar nevojat dhe boshllëqet në komunat e Kosovës. Ministria padyshim synon të luajë një rol koordinues ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal, si dhe ta mundësojë komunikimin përmes mekanizmave ekzistues ligjorë dhe administrativë.

Dëshiroj ta falënderoj UNDP-në për përkrahjen e tyre të vazhdueshme gjatë këtij hulumtimi. Shprehim mirënjohje dhe falënderime edhe për drejtorët komunalë, Shefat e sektorëve, nëpunësit civilë komunalë dhe anëtarët e kuvendeve komunale, të cilët ofruan përkrahje të jashtëzakonshme dhe shprehën gatishmërinë e tyre për të kontribuar dhe për t'i informuar gjetjet e këtij raporti.

Sinqerisht,

Rozafa Ukimeraj

Sekretare e Përgjithshme, MAPL

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Raporti aktual mbi nevojat dhe prioritetet për zhvillimin e kapaciteteve komunale mbështetet në hulumtimin e zhvilluar bashkërisht nga MAPL-ja dhe UNDP-ja. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte i dyfishtë. Nga njëra anë ishte vlerësimi i kapaciteteve të komunave sipas perceptimeve të zyrtarëve komunalë mbi boshllëqet dhe mangësitë e identifikuara. Kurse nga ana tjetër ishte të gjenerohej një vlerësim bazë dhe dëshmi që do të kontribuonin në hartimin e politikave dhe ndërhyrjeve për forcimin e kapaciteteve të komunave në ushtrimin e detyrave të punës në kuadër të obligimeve të tyre.

Ky raport mbulon kapacitetet komunale që janë vlerësuar në aspektin e disponueshmërisë së financave, personelit dhe ushtrimit të detyrave të punës në kuadër të obligimeve të tyre në përputhje me legjislacionin. Zyrtarët komunalë e vetë-vlerësuan shkallën e kapaciteteve të komunave në Kosovë dhe mjaftueshmërinë, dobësitë dhe sfidat me të cilat përballen komunat, duke i përfshirë nevojat për zhvillimin e kapaciteteve dhe trajnimin .

Për t'i identifikuar nevojat për zhvillimin e kapaciteteve dhe trajnimin, në këtë proces morën pjesë si përfaqësuesit legjislativë ashtu edhe ata ekzekutivë: anëtarë të kuvendeve komunale (si përfaqësues politikë), drejtorë (si të emëruar nga kryetarët e komunave) dhe nëpunësit civilë (si komponent i administratës civile). Të dhënat u grumbulluan duke përdorur një pyetësor të vetë-vlerësimit, në të cilin kontribuuan 1,307 të anketuar nga të gjitha komunat e Kosovës, në tri grupe të të anketuarve: Drejtorët e Drejtorive/Shefat e Sektorëve, zyrtarët komunalë dhe anëtarët e Kuvendit, të ndjekur nga diskutimet e FG dhe validimi.

Në vlerësim u përfshinë 12 fushat kyçe tematike si në vijim: Administrata dhe personeli; financat dhe buxheti; bujqësia; urbanizmi; të drejtat e njeriut; prokurimi komunal; arsimit; shërbimet publike; shëndetësia dhe mirëqenia sociale; kultura, rinia dhe sportet; zhvillimi ekonomik dhe turizmi, dhe integrimi evropian.

Këta tregues sektorialë dhe nën-treguesit përkatës janë zhvilluar duke u mbështetur në përgjigjet e normalizuara të anketës. Secili tregues dhe nën-tregues ndryshon në vlerë ndërmjet 0 dhe 3, ku intervali në mes të 0-0.5 tregon performancën komunale "shumë të dobët"; 0.5-1 tregon performancën "e dobët"; 1-1.5 tregon performancën "relativisht të dobët"; 1.5-2 tregon performancën "mesatare"; 2-2.5 tregon performancën "relativisht të mirë"; dhe 2.5-3 tregon performancën "shumë të mirë".

Raporti tregon se kapacitetet komunale për t'i zbatuar kompetencat e veta dhe ato të deleguara radhiten nga 1.35 (në nivelin e lartë të shkallës "relativisht të dobët") deri në 2.10 (në nivelin e ulët të shkallës "relativisht të mirë"), varësisht nga sektorët. Vetë-vlerësimi i përgjithshëm qëndron në 1.80 pikë, gjë që tregon se komunat në përgjithësi performojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare'.

Pavarësisht ndërhyrjeve nga aktorët ndërkombëtarë dhe vendorë për ta përmirësuar nivelin e kapaciteteve të komunave, hulumtimi aktual identifikoi dobësitë e përsëritura kronike. Përdorimi i kufizuar i sistemit ose mekanizmave ekzistues e pengon edhe përmirësimin e kapaciteteve të komunave. Zyrtarët komunalë konsiderojnë se komunat kanë dhënë shumë pak inpute (të dhëna) për nevojat, prioritetet dhe kërkesat e tyre reale.

Gjetjet tregojnë se zyrtarët komunalë konsiderojnë se sfidat kryesore përfshijnë kapacitetet e kufizuara dhe mungesën e zbatimit të ligjeve, rregulloreve, politikave dhe procedurave që përbëjnë bazën për funksionimin e qeverisjes lokale. Bashkë me kapacitetin e kufizuar profesional dhe organizativ, këto ndikojnë negativisht në cilësinë e ofrimit të shërbimeve komunale.

Gjithashtu, gjetjet tregojnë se proceset e zhvillimit të kapaciteteve komunale ngadalësohen nga mungesa e koordinimit adekuat në kuadër të komunave dhe ndërmjet tyre, si dhe në mes të komunave dhe nivelit qendror. Ekziston nevoja për forcimin e koordinimit dhe komunikimit në mes të dy niveleve të administratës publike dhe të siguruarit që janë ndërmarrë masat për adresimin e nevojave të komunave.

Në nivelin e zhvillimit të politikave, gjetjet tregojnë inpute (të dhëna) të kufizuara nga komunat dhe shpërndarje joadekuate të informacionit nga niveli qendror. Kjo ndikon në zbatimin në kohë të kornizës së politikave dhe në cilësinë e shërbimeve, ashtu si edhe në mospërputhjen në mes të kompetencave dhe buxhetit në dispozicion.

Siç është cekur në raport, komunat kanë nivele të ndryshme të kapaciteteve, gjë që kërkon një përkrahje pothuajse të përshtatur dhe - në disa raste - një vlerësim më të thellë për t'i identifikuar shkaqet rrënjësore për nivelet më të ulëta të kapaciteteve. Pasi që rekomandimet specifike mund të veprojnë si pengesë për shkak të rrezikut të pandarë të zhvillimit të një qasjeje "të unifikuar" për sektorët dhe komunat me nevoja të ndryshme, atëherë rekomandimet e listuara në Seksionin IV të raportit duhet të lexohen si udhëzime të përgjithshme kur të hartohen iniciativat e qëndrueshme për zhvillimin e kapaciteteve.

1. HYRJA

Duke u bazuar në parimet kryesore të përcaktuara në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale¹, Kosova ka arritur të ndërtojë një sistem solid të vetëqeverisjes lokale. Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje², komunat u ofrojnë qytetarëve një sërë shërbimesh, që rrjedhin nga (i) kompetencat vetanake, (ii) kompetencat e deleguara, dhe (iii) kompetencat e zgjeruara për komunat me shumicë serbe. Gjatë disa viteve të fundit, sistemi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë është duke kaluar nëpër reforma politike, ligjore, administrative, organizative, funksionale, territoriale dhe financiare.

Korniza ekzistuese ligjore i përmbush parakushtet për një sistem të avancuar të qeverisjes lokale. Ajo siguron autonomi të mjaftueshme për komunat, duke u lejuar të marrin udhëheqjen për çështjet komunale.

E drejta për vetëqeverisje lokale është e garantuar me Kushtetutën e Kosovës³ dhe kryesisht rregullohet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.⁴ Ky Ligj, ndër të tjera, përcakton statusin ligjor të komunave të Kosovës, kompetencat e tyre, parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, bashkëpunimin dhe marrëveshjet ndër-komunale, si dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe institucioneve të nivelit qendror. Ligjet, rregullat ose vendimet tjera të ndërlidhura, e funksionalizojnë më tej Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe rregullojnë çështjet specifike të sektorit (Ligji për Financat e Pushtetit Lokal⁵, Rregullorja për Transparencën,⁶ etj.).

MAPL është organi kryesor përgjegjës për avancimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Misioni i saj është rritja e autonomisë lokale dhe forcimi i kapaciteteve të komunave përmes pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, përfaqësimit demokratik dhe ofrimit të shërbimeve me kosto efektive, të cilat të gjitha bashkë kontribuojnë në cilësinë e jetës, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik lokal. MAPL ka një interes të qartë për ta përmirësuar funksionimin e komunave dhe ofrimin e shërbimeve në mënyrë efektive, efikase, llogaridhënëse dhe transparente.

Pavarësisht nga korniza ekzistuese ligjore dhe fakti që komunat gëzojnë autonomi në ofrimin e shërbimeve, ky hulumtim përcakton se komunat shpesh kanë mungesë të kapaciteteve të duhura për t'i zbatuar detyrimet e parashikuara në legjisllacionin ekzistues, i cili, nga ana tjetër, u pengon në përmbushjen e nevojave të qytetarëve.⁷ Kjo gjetje u përsërit edhe në Studimin e Fizibilitetit të vitit 2015 - Sistemi i Zhvillimit të Kapaciteteve për Komunat në Kosovë, i autorizuar nga Projekti i Decentralizimit dhe Përkrahjes Komunale. Për t'i kuptuar më mirë nivelet e kapaciteteve në nivelin komunal, në mënyrë që të jenë në gjendje të dizajnojnë ndërhyrje efektive dhe efikase, MAPL dhe UNDP në Kosovë vendosën ta iniciojnë vetë-vlerësimin e kapaciteteve të të gjitha komunave të Kosovës. Ky hulumtim përcjell raportin fillestar të vitit 2009, kur UNDP dhe MAPL zhvilluan vetë-vlerësimin e parë të kapaciteteve komunale. Në atë kohë, raporti siguroi

1 Këshilli i Evropës (1985), *Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale*, <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/122>

2 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008), *Ligji për vetëqeverisjen lokale*, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_en.pdf.

3 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008), *Kushtetuta e Kosovës*, <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>.

4 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008), *Ligji për vetëqeverisjen lokale*, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_en.pdf

5 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008), *Ligji për financat e pushtetit lokal*, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_en.pdf

6 Komuna e Prishtinës (2009). *Rregullorja për Transparencën*. http://www.online-transparency.org/repository/docs/Regullorja_per_transparence_03.07.2009.pdf

7 UNDP (2009), *Vlerësimi i Kapaciteteve Komunale*

një vlerësim bazë për boshllëqet dhe asetet e kapaciteteve dhe zonat e identifikuara që kërkonin vëmendje institucionale.

Edhe pse hulumtimi aktual e ka përdorur pyetësoin e hartuar për studimin e vitit 2009, metodologjia ka ndryshuar për ta lejuar mbledhjen e të dhënave statistikore. Objektivi i këtij raporti është ta bëjë vlerësimin e kapaciteteve dhe nevojave të të gjitha komunave të Kosovës përmes një ankete perceptimi të realizuar me përfaqësuesit komunalë (drejtorët/shefat e sektorëve, nëpunësit civilë komunalë dhe anëtarët e kuvendeve) dhe diskutimeve tematike të FG-ve. Të dhënat u mbledhën përmes një ankete perceptimi me 1,307 të anketuar nga të gjitha komunat e Kosovës, nga kategoritë e lartpërmendura. Shpresohet se treguesit e gjeneruar për këtë raport do të ofrojnë një nivel bazë që do të shërbejë si pikë krahasimi për mbledhjen e të dhënave në të ardhmen mbi kapacitetet komunale.

Ky raport ofron një pasqyrë të kapaciteteve komunale, siç shihet nga strukturat komunale. Megjithatë, për ta fituar të kuptuarit e plotë të çështjeve komunale, raporti duhet të lexohet së bashku me anketat e tjera, përkatësisht Raportin Mozaiku 2015,⁸ dhe Raportin e Performancës Komunale të MAPL-së. I pari, i bërë çdo tre vjet, ofron njohuri nga këndvështrimi i qytetarëve për ofrimin e shërbimeve,⁹ ndërsa tjetri, i cili kryhet në baza vjetore, ofron informata për funksionimin e komunave nga pikëpamja e MAPL-së. Triangulimi i të dhënave nga tre raportet do të ofrojë njohuri shtesë për çështjet kyçe në nivelin komunal, të cilat asnjëri raport nuk i kap individualisht.

Raporti është i strukturuar si më poshtë. Seksioni 2 përshkruan metodologjinë e përgjithshme të përdorur për kryerjen e anketës dhe organizimin e diskutimeve të FG-ve. Seksioni 3 paraqet çdo tregues komunal dhe nën-treguesit përbërës, si dhe i ofron përgjigjet më të vlerësuara të secilës variabël sektoriale. Në fund, Seksioni 4 e përmbyll raportin dhe jep rekomandime të përgjithshme mbi nivelet më të ulëta të kapaciteteve, siç janë identifikuar përmes treguesve dhe nën-treguesve.

8 UNDP, MAPL dhe USAID (2015), *Mozaiku 2015*, http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo%20Mosaic%202015_english.pdf

9 Anketa Mozaiku përfshin rreth 6,700 qytetarë, të ndarë sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, rezidencës urbane/rurale, etj., dhe konsiderohet si studimi më i madh pas regjistrimit të popullsisë.

2. METODOLOGJIA E PËRGJITHSHME

Për ta siguruar besueshmërinë e burimeve janë përdorur dy mënyra të mbëldhjes së të dhënave: (a) një anketë sasiore me 1,307 përfaqësues të komunave nga 38 komuna; dhe (b) gjashtë fokus grupe tematike me nëpunësit civilë komunalë.

Në vetë-vlerësim morën pjesë si përfaqësuesit legjislativë ashtu edhe ata ekzekutivë. U konsiderua e rëndësishme të kuptohet si i percepton kapacitetet komunale secili nga këto nivele, pasi kjo gjithashtu ka ndikim në mënyrën si të adresohen boshllëqet e identifikuar. Të emëruarit politikë dhe përfaqësuesit politikë nuk u përfshinë në diskutimet e FG-ve në mënyrë që të sigurohej një mjedis i hapur për diskutime të sinqerta me nëpunësit civilë.

2.1. Metodologjia e anketës

Pyetësi

Pyetësi i përdorur në këtë anketë u bazua në pyetësin e vetë-vlerësimit të vitit 2009. U mbajtën disa takime të grupeve punuese në mes të UNDP-së dhe MAPL-së për ta shqyrtuar pyetësin me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë me politikën aktuale dhe kornizën legjislative, si dhe për t'i standardizuar pyetjet dhe për t'i mbledhur të dhënat valide statistikore. Gjithashtu, MAPL-ja e ka validuar pyetësin me disa ministri të linjës. Janë kryer katërbëdhjetë (14) pilot intervista për ta testuar përshtatshmërinë e pyetjeve dhe procesin në përgjithësi.

Njëzet e katër (24) kompetenca vetanake dhe të deleguara u organizuan në dymbëdhjetë fusha vlerësimi¹⁰, me Integrimin Evropian të shtuar për vetë-vlerësimin e vitit 2017. Pyetësi përbëhet nga pyetje të mbyllura, të cilat e bëjnë matjen e perceptimeve tëpërfaqësuesve komunalë mbi kapacitetet komunale kundrejt kompetencave vetanake dhe të deleguara. Duhet të theksohet se Drejtorëve/Shefave të Sektorëve dhe nëpunësve civilë komunalë u janë shtruar pyetje që kanë qenë të lidhura vetëm me sektorët e tyre përkatës.

Korniza mostër

Gjithsej, u kryen 1,307 intervista të drejtpërdrejta me grupet e mëposhtme në të gjitha 38 komunat e Kosovës:

- o Drejtorët e Drejtorive/Shefat e Sektorëve,
- o Nëpunësit civilë komunalë, dhe
- o Anëtarët e Kuvendit.

U tentua një shpërndarje e përfaqësuesve komunalë për ta siguruar proporcionalitetin me madhësinë e secilës kategori në mbarë popullatën. Shpërndarja e përgjithshme u përsërit në çdo komunë, me përjashtim të rasteve kur struktura komunale ishte e ndryshme. Vini re se për ta shmangur anshmërinë potenciale,

¹⁰ Integrimi Evropian u shtua për vetë-vlerësimin e vitit 2017.

secili grup u trajtua në mënyrë të barabartë në gjetjet e përgjithshme. Tabela 1 përshkruan numrin e përgjithshëm të intervistave të kryera me secilën kategori të përfaqësuesve komunalë.

TABELA 1: Shpërndarja e intervistave nga përfaqësuesit komunalë

Përfaqësues komunalë	Intervista
Drejtorë/Shefa të Sektorëve	593
Nëpunës civilë komunalë	443
Anëtarë të Kuvendit	271
Gjithsej	1,307

Puna në terren

Në fund të tetorit dhe në fillim të nëntorit 2017, 30 anketues të trajnuar meshkuj dhe femra zhvilluan intervista të drejtpërdrejta. Trajnimi mbuloi shpjegime të detajuara të pyetjeve, të përgjigjeve të mundshme të papërshtatshme, si dhe ofroi udhëzime për procesin e intervistimit, të përcjellur me ushtrime praktike. Puna në terren u koordinua nga udhëheqësi i dedikuar i ekipit dhe koordinatori në bashkëpunim me UNDP-në.

Përpunimi i të dhënave dhe sigurimi i cilësisë

Të dhënat u transferuan në mënyrë elektronike nga tabletët në Paket Statistikore për Shkencat Shoqërore (SPSS) dhe u koduan në kategori të etiketuara, duke i bërë të përshtatshme për përpunim të mëtejshëm. U zhvilluan aktivitetet e sigurimit të cilësisë, me ç'rast 20% të të anketuarve u rivizituan dhe një numër i përzgjedhur i pyetjeve i rishtruan për verifikim. Në fund, 20% e të anketuarve janë kontaktuar me telefon në mënyrë që të verifikohen dhe të validohen të dhënat.

Hapat për llogaritjen e treguesve

Secili tregues përbëhet nga nën-treguesit të cilët bazohen në pyetje të normalizuara në një shkallë nga 0 deri në 3, ku 0 përfaqëson performancë 'shumë të dobët' dhe 3 përfaqëson performancë 'shumë të mirë'. Pyetjet dikotomike, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të normalizohen në shkallë prej 0 deri në 3, dhe si të tilla nuk mund të përfshihen në mesin e treguesve. Metoda e shkallës uniforme lejon një krahasim më të lehtë në mes të sektorëve të ndryshëm. Për më tepër, është e dobishme në aspektin e analizave statistikore (duke krijuar regres dhe korrelacion), dhe për hulumtime empirike në përgjithësi. Për ta parë se çfarë tregon secili rezultat, shihni spektrin.

Shumë i dobët	Dobët	Relativisht i dobët	Mesatar	Relativisht i mirë	Shumë i mirë
0	0.5	1	1.5	2	2.5 3

Tabela 2 tregon listën dhe strukturën e treguesve dhe nën-treguesve.

TABELA 2: *Struktura e treguesve dhe nën-treguesve*

TREGUESI	NËN-TREGUESI
Administrata dhe personeli	<ul style="list-style-type: none"> • Transparenca dhe llogaridhënia • Bashkëpunimi • Masa e performancës • Infrastruktura e TI-së • Kujtesa institucionale • Infrastruktura e personelit • Infrastruktura fizike
Bujqësi	<ul style="list-style-type: none"> • Toka bujqësore • Bashkëpunimi bujqësor
Buxheti dhe Financat	<ul style="list-style-type: none"> • Financat Ligjore Lokale • Planifikimi i buxhetit • Kontrolli i brendshëm i financave publike • Të hyrat vetanake
KRS	<ul style="list-style-type: none"> • Planet e KRS-së • Qendrat e KRS-së dhe eventet • Përkrahja financiare
Zhvillimi ekonomik dhe turizmi	<ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi dhe zhvillimi ekonomik • Turizmi
Arsimi	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret shkollore • Arsimi para-shkollor • Arsimi fillor dhe i mesëm • Personeli mësimdhënës
Integrimi Evropian	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka zbërthim të mëtejshëm
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	<ul style="list-style-type: none"> • Kujdesi shëndetësor familjar • Veprimtaria private shëndetësore • Personeli shëndetësor • Shërbimet sociale
Të drejtat e njeriut	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza ligjore e të drejtave të njeriut • Komunitetet dhe kthimi • Komunikimi dhe gjuha
Prokurimi komunal	<ul style="list-style-type: none"> • Prioritizimi i prokurimit • Planifikimi i prokurimit • Etika e prokurimit
Shërbimet publike dhe emergjente	<ul style="list-style-type: none"> • Uji, kanalizimi dhe mbeturinat • Emergjencat në raste të zjarrit • Transporti publik • Mirëmbajtja e rrugëve publike
Urbanizmi	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret urbane • Mbrojtja e mjedisit • Gjeodezi dhe Kadastër • Planifikim urban

2.2. Metodologjia e Fokus Grupeve

Udhëzuesit e FG-ve

Udhëzuesit e FG-ve janë zhvilluar për ta përcaktuar fushëveprimin e diskutimeve të FG-ve. Secili udhëzues përmbante një sërë pyetjesh që kishin të bënin me sektorin dhe korrespondonin me ato që ishin përfshirë në pyetësor. Pesë FG tematike janë mbajtur mes 24 nëntorit dhe 8 dhjetorit 2017. Një FG i dedikuar mbulonte të gjitha temat kryesore të organizuara për ta mundësuar pjesëmarrjen e komunave me shumicë serbe në proces:

- FG1: Arsimi, KRS
- FG2: Zhvillimi i Ekonomisë, Turizmit dhe Bujqësisë
- FG3: Urbanizmi, Ndërtimi dhe Mjedisi
- FG4: Shërbimet publike, kujdesi shëndetësor dhe mirëqenia sociale
- FG5: Financat, Prokurimi dhe Auditimi i brendshëm
- FG6: Komunitatet me shumicë serbe.

Meqenëse Integrimi Evropian është një çështje e ndërthurur, është diskutuar në kuadër të FG-ve ekzistuese.

3. GJETJET KRYESORE

Ky seksion përmban gjetjet kyçe të gjeneruara nga anketimi i bazuar në perceptime dhe nga diskutimet e FG-ve të mbajtura me përfaqësuesit komunalë. Bazuar në treguesit dhe nën-treguesit në shkallën e normalizuar, e cila siguron përgjigjet më të vlerësuara të secilës variabël sektoriale, për secilin sektor janë listuar pikat e forta dhe të dobëta të konstatuara nga anketa.


Raporti tregon se kapacitetet komunale për t'i zbatuar kompetencat vetanake dhe ato të deleguara luhaten nga 1.35 (në nivelin e lartë të shkallës "relativisht të dobët") deri në 2.10 (në nivelin e ulët të shkallës "relativisht të mirë"), varësisht nga sektorët. Vetë-vlerësimi i përgjithshëm qëndron në 1.80 pikë, gjë që tregon se komunat në përgjithësi performojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare'. Tabelat në këtë seksion (3 deri në 14) i japin vetëm përgjigjet më të vlerësuara në përqindje.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë informata të detajuara për nivelin e kapaciteteve komunale në bazë të sektorëve dhe nënsektorëve. Shtojca A përmban tabelat përshkruese të statistikave për secilën pyetje individuale, të ndara sipas përgjigjeve të dhëna nga përfaqësuesit komunalë.

3.1. Administrata dhe personeli

Treguesi i administratës dhe personelit përbëhet nga shtatë nën-tregues siç është paraqitur në Figurën 1. Komunat morën 2.10 pikë, gjë që e vendos performancën e tyre në nivelin e ulët të shkallës "relativisht të mirë". Kjo sugjeron se në përgjithësi përfaqësuesit komunalë kanë një pikëpamje pozitive mbi çështjet që lidhen me administratën dhe personelin.

FIGURA 1: Treguesi i administratës dhe personelit dhe nën-treguesit e tij



Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës "relativisht të mirë" në nën-treguesin e Transparencës dhe Llogaridhënies, që u vlerësua me 2.30 pikë. Shumica dërrmuese e të anketuarve tregojnë se komuna e tyre ka mekanizma të përcaktuar qartë dhe efektiv që u mundësojnë qytetarëve të ankohen kundër vendimeve

ekzekutive dhe administrative. Pavarësisht nga kjo pikëpamje e përgjithshme, diskutimet e FG-ve zbuluan raste kur ankesat u janë parashtruar nëpunësve të gabuar civilë komunalë, të cilët nuk i kanë përcjellë tek të adresuarit e synuar. Kjo është pjesërisht si rezultat i informatave të paqarta të komunave për qytetarët në lidhje me procedurat e ankimimit. Mbi dy të tretat e të anketuarve konsiderojnë se aktet komunale bëhen publike dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Transparencë në Komuna.¹¹ Një shqetësim i ngritur nga pjesëmarrësit e FG-ve të komunave me shumicë serbe ka të bëjë me cilësinë e përkthimit të akteve ligjore komunale. Këto përkthime të dobëta përmbajnë dykuptimësi dhe kuptime të paqëllimta.

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës “relativisht të mirë” në nën-treguesin e Bashkëpunimit që u vlerësua me 2.26 pikë. Bashkëpunimi në kuadër të komunës, me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) dhe shoqatat e biznesit, është në një nivel relativisht të mirë. Sipas pjesëmarrësve të FG-ve, takimet mujore të bordit drejtues të komunës janë mjaft efektive në mundësimin e koordinimit në kuadër të komunës. Nga ana tjetër, bashkëpunimi dhe koordinimi me OSHC-të, shoqatat e biznesit dhe palët e tjera të interesit ndodh kryesisht kur komunat hartojnë dokumente strategjike. Në disa raste specifike, e gjithë përmbajtja e këtyre dokumenteve strategjike përcaktohet nga inputet (të dhënat) e nxjerra nga këto palë të interesit. Rregullorja mbi Standardet Minimale për Konsultime Publike,¹² e cila hyri në fuqi në vitin 2016, ka ndikuar pozitivisht në konsultimet në mes të autoriteteve publike (duke përfshirë komunat), palëve e interesuara dhe publikut, duke përfshirë OSHC-të dhe Organizatat Joqeveritare (OJQ).

Pjesëmarrësit e FG-ve konsiderojnë se komunat shpesh neglizhohen nga niveli qendror kur hartohen dokumentet strategjike kombëtare, edhe pse ato preken drejtpërdrejt prej tyre. Për më tepër, ata theksojnë se dallimet politike në nivel qendror dhe komunal shpesh e pengojnë bashkëpunimin. Gjithashtu, pjesëmarrësit e FG-ve theksuan mungesën e mekanizmave formalë për bashkëpunim të rregullt dhe shkëmbim të praktikave më të mira, përveç Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), i cili kryesisht i mbledh përfaqësuesit politikë. Teksa shumica e pjesëmarrësve të FG-ve thonë se Memorandumet e institucionalizuara të Mirëkuptimit përbëjnë një nga aktet për bashkëpunimin ndër-komunal, ato nuk shfrytëzohen aq shpesh sa do të mund të shfrytëzoheshin.

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës “relativisht të mirë” në nën-treguesin e Matjes së Performancës dhe të Infrastrukturës së TI-së, të cilët u vlerësuan me 2.23 dhe respektivisht me 2.17. Rreth dy të tretat e të anketuarve besojnë se vlerësimi i performancës së nëpunësve civilë të komunës zhvillohet siç përcaktohet nga Rregullorja për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë.¹³ Pjesëmarrësit e FG-ve pranojnë se ndonëse plani i zhvillimit të trajnimit bazohet në vlerësimin e performancës, nuk është mjaftueshëm specifik për ta siguruar rritjen e duhur të kapaciteteve. Sa i përket TI-së, diskutimet e FG-ve zbuluan se përdorimi i llogarive private të e-mailit është mjaft i përhapur për shkak të shpejtësisë së ulët të internetit dhe kapaciteteve të kufizuara të ruajtjes së llogarive zyrtare të postës elektronike. Kjo ka një efekt negativ në efikasitetin dhe cilësinë e komunikimit, duke përfshirë kryerjen në kohë të detyrave dhe përgjegjësi.

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës “relativisht të mirë” në nën-treguesin e Kujtesës Institucionale dhe Personelit, të cilët u vlerësuan me 2.08 dhe respektivisht me 2.05. Megjithatë nën-treguesi i Kujtesës Institucionale është më i lartë, pjesëmarrësit e FG-ve pajtohen se komunat e tyre nuk kanë as mekanizmat e duhur dhe as kapacitete njerëzore për të ruajtur kujtesën institucionale. Ata gjithashtu theksojnë mungesën e planifikimit të vazhdimësisë që e mundëson kalimin mes nëpunësve civilë komunalë që janë duke u larguar dhe atyre që sapo

11 MAPL (2013). *Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna*, <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/6840a2b1-4687-4d60-92d2-20f903c80edd/Udhezim-administrativ.aspx>

12 <https://zqm.rks-gov.net/Portals/0/Regulation%20on%20minimum%20standards.pdf>

13 Zyra e Kryeministrit (2012). *Rregullorja për Vlerësimin e Rezultateve në Punë*, http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja_nr_19_2012_per_Vlersimin_e_rzultateve_ne_pune.pdf

janë rekrutuar. Është interesante që diskutimi i nën-treguesit të Personelit tregon se rreth gjysma e të anketuarve mendojnë se nëpunësit civilë komunalë kanë përvojë pune, kualifikim dhe përkushtim të konsiderueshëm ndaj përgjegjësive të tyre. Megjithatë, rreth një e treta e të anketuarve konsiderojnë se nëpunësit civilë nuk janë plotësisht të pavarur në ushtrimin e detyrave të tyre, pasi mbizotëron një shkallë e caktuar e ndërhyrjeve politike.

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Infrastrukturës Fizike që u vlerësua me 1.63 pikë. Sipas diskutimeve të FG-ve, arsyeja kryesore për këtë rezultat është numri i kufizuar i automjeteve zyrtare, veçanërisht në arsim, inspektim dhe sektorë të tjerë që kërkojnë punë në terren.

TABELA 3: Treguesi i administratës dhe personelit


	Drejtorë/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
Mekanizma për paraqitjen e ankesave të qytetarëve kundër vendimeve ekzekutive dhe administrative				
Janë vendosur mekanizma për paraqitjen e ankesave të qytetarëve kundër vendimeve ekzekutive dhe administrative.	95,8%	93,0%	89,7%	92,8%
Procesi i paraqitjes së ankesave është i definuar dhe i strukturuar qartë. Ankesat gjithmonë merren parasysh dhe adresohen në nivele të përshtatshme.	74,1%	69,2%	42,0%	61,8%
Bashkëpunimi dhe koordinimi në kuadër të komunës dhe jashtë saj				
Niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit me drejtoritë e tjera komunale është i lartë.	63,1%	49,4%	26,9%	46,5%
Niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit me nivelin qendror (ministritë) është i lartë	48,1%	42,4%	22,5%	37,7%
Niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile është i lartë.	45,4%	36,3%	25,5%	35,7%
Niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit me anëtarët e komunitetit të biznesit në kuadër të komunës dhe jashtë saj është i lartë.	35,4%	25,7%	17,3%	26,2%
Bashkëpunimi ndër-komunal				
Ekziston një akt komunal që përcakton bashkëpunimin ndërkomunal dhe pasohet nga Memorandumi i institucionalizuar i Mirëkuptimit ose marrëveshje të tjera ligjore.	60,7%	55,8%	50,2%	55,5%
Bashkëpunimi ndër-komunal zhvillohet nëpërmjet prioriteteve dhe nevojave të përbashkëta, ku vendimet transmetohen dhe zbatohen.	57,7%	52,1%	43,5%	51,1%
Transparenca, publikimi i dokumentacionit				
Qasja në dokumentet publike është në dispozicion në baza të rregullta.	77,9%	74,0%	52,0%	68,0%

Qasja në dokumente jepet brenda afateve ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi.	86,8%	78,8%	66,8%	77,5%
Niveli i publikimit të dokumenteve komunale është i lartë, sepse procedurat për publikimin e vendimeve dhe dokumenteve komunale zbatohen tërësisht.	67,1%	61,6%	36,2%	55,0%
Dokumentet komunale përkthehen gjithmonë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës	28,0%	31,2%	24,7%	28,0%
TI-ja, kompjuterët, përdorimi, programet, rrjeti dhe e-maili, e-komunat				
Niveli i infrastrukturës së teknologjisë informative (TI) është i lartë dhe i qasshëm nga të gjithë.	42,2%	41,8%	32,8%	38,9%
Infrastruktura e TI-së përdoret shumë nga personeli komunal.	48,7%	49,7%	34,7%	44,4%
E-mailët zyrtarë përdoren nga i gjithë personeli në të gjitha nivelet.	62,4%	64,3%	42,1%	56,3%
Infrastruktura fizike				
Mjedisi i punës në kuadër të institucionit ofron hapësirë shumë të favorshme për punë individuale, bashkëbisedime konfidenciale, punë në grupe etj.	21,2%	16,5%	10,3%	16,0%
Numri i automjeteve zyrtare është i mjaftueshëm në kuadër të institucionit dhe është i menaxhuar mirë.	45,4%	44,0%	37,3%	42,2%
Kujtesa institucionale - menaxhimi i njohurive				
Komuna ka një sistem, i cili mundëson grumbullimin dhe menaxhimin e informacionit në lidhje me dokumentacionin, procedurat dhe të dhënat në përgjithësi (informacionin e nevojshëm, të dhënat historike, procedurat, etj.), i përdorur nga të gjithë.	44,0%	43,3%	29,5%	39,0%
Matja e performancës dhe vlerësimi vjetor dhe 6-mujor i institucionit				
Është një sistem i zhvilluar mirë, gjithëpërfshirës dhe i integruar që përdoret rregullisht për ta vlerësuar performancën e komunës.	44,2%	33,0%	22,1%	33,1%
Vlerësimi vjetor i personelit kryhet rregullisht dhe përdoret për planin e ardhshëm të zhvillimit të personelit.	73,4%	63,7%	44,6%	60,6%
Menaxhimi i burimeve njerëzore - Personeli në përgjithësi; Varësia nga eprori				
Procesi i rekrutimit të personelit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin për Shërbimin Civil (LSHC).	78,8%	74,0%	56,1%	69,6%
Personeli në drejtorinë tuaj ka përvoja relevante të punës, kualifikime dhe angazhim të lartë në trajtimin e përgjegjësive të dhëna.	49,4%	52,1%	28,4%	43,3%
Personelit është krejtësisht i pavarur nga menaxheri i drejtpërdrejtë	51,3%	47,4%	18,8%	39,2%

3.2. Buxheti dhe Financat

Treguesi i Buxhetit dhe Financave përbëhet nga katër nën-tregues siç janë paraqitur në Figurën 2. Komunitat u vlerësuan me 2.07 pikë, gjë që e vendos performancën e tyre në nivelin e ulët të shkallës “relativisht të mirë”. Meqenëse auditimi i brendshëm nuk është i lidhur drejtpërdrejt me buxhetin dhe financat, variablat e tij nuk përfshihen në tregues, por interpretohen individualisht.

FIGURA 2: Treguesi i buxhetit dhe financave dhe nën-treguesit e tij



Komunitat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës “relativisht të mirë” në nën-treguesin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike, i cili u vlerësua me 2.17 pikë. Më shumë se gjysma e të anketuarve konsiderojnë se kontrolli i brendshëm në financat publike kryhet në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e Thesarit. Një numër i ngjashëm i të anketuarve besojnë se fondet përdoren në mënyrën e duhur.

Komunitat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës “relativisht të mirë” në nën-treguesin e Planifikimit të Buxhetit, i cili u vlerësua me 2.06 pikë. Shumica e të anketuarve tregojnë se niveli i aftësive të personelit komunal për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) është i lartë. Përveç kësaj, rreth dy të tretat e të anketuarve konsiderojnë se KASH-i kryhet në baza të rregullta dhe se ekzekutivi i Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave (MF) merr vendime që janë në përputhje me kornizën ligjore ekzistuese. Për më tepër, më shumë se gjysma e të anketuarve besojnë se anëtarët përgjegjës të personelit të komunës kanë përvojë në përgatitjen dhe prezantimin e projekt propozimeve buxhetore. Një përqindje e ngjashme e të anketuarve besojnë se të gjitha drejtoritë komunale tregojnë përgjegjësi dhe janë të angazhuar mirë në procesin e planifikimit të buxhetit.

Pjesëmarrësit e FG-ve ndajnë një pikëpamje pak më pesimiste mbi planifikimin dhe alokimin e buxhetit. Ata pajtohen se buxheti nuk është gjithmonë në përputhje me nevojat e komunës. Ata konsiderojnë se tavanet buxhetore të vendosura nga MF-ja pengojnë efektivitetin e komunave. Pjesëmarrësit e FG-ve besojnë se këto kufizime janë mjaft shpesh të vendosura në mënyrë arbitrare dhe i parandalojnë komunitat nga adresimi i nevojave komunale për shkak të alokimeve të pamjaftueshme. Pjesëmarrësit e FG-ve gjithashtu bien dakord se mjaft shpesh ndikimet politike, më shumë se sa dokumentet strategjike, i përcaktojnë prioritetet komunale.

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës “relativisht të mirë” në nën-treguesin e Financave Ligjore Lokale që u vlerësua me 2.08 pikë. Më shumë se gjysma e të anketuarve besojnë se Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal zbatohet plotësisht, dhe një numër i ngjashëm besojnë se personeli përgjegjës i ka aftësitë e nevojshme dhe përvojën e mjaftueshme.

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës ‘mesatare’ në nën-treguesin e të Hyrave Vetanake, i cili u vlerësua me 1.95 pikë. Të Hyrat Vetanake përfshijnë taksat komunale, tarifatat, pagesat e përdoruesve, qiratë dhe kategoritë e tjera të ngjashme të të hyrave. Të hyrat vetanake të komunave duket se janë disi më pak të kënaqshme në krahasim me fushat e tjera të financave komunale. Më shumë se dy të tretat e të anketuarve mendojnë se kjo mund t’i atribuohet kapaciteteve mesatare të komunave për t’i mbledhur këto lloje të hyrash. Një vërejtje e përgjithshme nga pjesëmarrësit e FG-ve është se komunat nuk janë realiste në lidhje me shumën totale të të hyrave vetanake që mund të mblidhen. Kjo i detyrohet kryesisht planifikimit të pasaktë.

Edhe pse shumica dërrmuese e të anketuarve janë të vetëdijshëm se komunat kanë rregullore për tarifatat, pagesat dhe gjatë, vetëm rreth gjysma e tyre mendojnë se këto rregullore zbatohen plotësisht. Rreth gjysma e të anketuarve pohojnë se këto rregullore shqyrtohen çdo vit dhe gjithmonë dorëzohen tek homologët në MAPL për miratimin e tyre.

TABELA 4: Buxheti dhe financat

	Drejtor/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
Ligji për Financat e Pushtetit Lokal				
Ligji për Financat e Pushtetit Lokal është duke u zbatuar plotësisht.	68,1%	71,4%	30,3%	56,6%
Komuna ka shkathtësi të nivelit të lartë dhe përvojë të mjaftueshme për ta zbatuar Ligjin për financat lokale.	65,2%	68,6%	29,2%	54,3%
Korniza afatmesme buxhetore (KAB)				
Komuna ka shkathtësi të nivelit të lartë dhe përvojë të mjaftueshme, për të përgatitur kornizën afatmesme buxhetore (KAB).	65,2%	62,9%	24,7%	50,9%
KASH-i kryhet pothuajse në baza të rregullta. Vendimet ekzekutive merren në përputhje me KASH-in.	76,8%	62,9%	41,7%	60,5%
Planifikimi i buxhetit, qarkorja e brendshme e buxhetit, dëgjimet publike				
Të gjitha drejtoritë janë përgjegjëse dhe të përfshira në planifikimin e buxhetit.	68,1%	68,6%	33,9%	56,9%
Komuna ka shkathtësi të nivelit të lartë dhe përvojë të mjaftueshme për planifikimin e buxhetit dhe hartimin e qarkores së buxhetit.	66,7%	71,4%	29,5%	55,9%


Ka mekanizma të avancuar të vendosur për identifikimin dhe përzgjedhjen e projekteve.	33,0%	32,6%	14,4%	26,7%
Kriteret e përzgjedhjes së projekteve janë plotësisht objektive.	39,4%	30,4%	11,4%	27,1%
Shkathtësitë dhe përvojat për përgatitjen e projekteve janë në një nivel të lartë.	61,7%	43,5%	24,7%	43,3%
Kontrolli i brendshëm i financave publike				
Kontrolli i brendshëm i financave publike bëhet sipas zbatimit të plotë të rregullave dhe udhëzimeve të Thesarit.	68,1%	65,2%	26,9%	53,4%
Fondet përdoren plotësisht dhe në mënyrë të përshtatshme.	69,1%	65,2%	32,1%	55,5%
Ka mekanizma adekuat për kontrollin e brendshëm të financave publike.	60,6%	60,9%	30,3%	50,6%
Të Hyrat Vetanake				
Komuna ka rregullore për tarifatat, pagesat dhe gjambat dhe ato janë duke u zbatuar plotësisht.	68,1%	71,7%	24,0%	54,6%
Ka nivel të lartë të mbledhjes së të hyrave vetanake.	34,0%	26,1%	20,7%	26,9%
Komuna ka shkathtësi adekuate për t'i siguruar të hyrat vetanake.	36,2%	39,1%	17,0%	30,8%
Rishikohet në baza vjetore rregullorja për gjambat dhe dënimet, dhe dorëzohet gjithmonë për vlerësimin e ligjshmërisë në MAPL.	56,4%	50,0%	28,0%	44,8%
Komuna ka kapacitete adekuate për auditim të brendshëm.	44,7%	30,4%	15,5%	30,2%
Komuna ka plane të auditimit dhe ato janë të rregullta dhe në përputhje me procedurat.	67,0%	56,5%	30,3%	51,3%
Auditori i brendshëm ka pavarësi të plotë profesionale.	63,0%	62,2%	33,0%	52,7%
Komuna ka kapacitete adekuate për ta siguruar zbatimin e parimeve etike dhe të kodit të sjelljes për ekipin e prokurimit.	43,6%	32,6%	12,9%	29,7%
Koordinimi me nivelin qendror është i mirë.	51,1%	45,7%	17,7%	38,1%

AUDITIMI I BRENDSHËM

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënie¹⁴ i obligon komunat që të themelojnë dhe të mbajnë Njësine e Auditimit të Brendshëm.¹⁵ Ligji për Auditimin e Brendshëm përcakton se auditimet e brendshme kryhen me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës së subjekteve të sektorit publik në një mënyrë që e rrit nivelin e shërbimeve që u ofrohen përdoruesve, përfituesve dhe qytetarëve të Kosovës. Në këtë drejtim, Ligji krijon një sistem institucional për të siguruar një funksion adekuat të auditimeve të brendshme.


Anketa tregon se 45% e të anketuarve besojnë se komuna e tyre ka kapacitete të moderuara për auditim të brendshëm, 30% mendojnë se komuna e tyre ka kapacitete adekuate, 23% besojnë se komuna ka kapacitete të kufizuara për auditim të brendshëm, ndërsa 2% të mbetur pohojnë se komuna e tyre nuk ka Njësi të Auditimit të Brendshëm.

Cili është niveli i kapaciteteve komunale për auditimin e brendshëm?



Më tej, 51% e të anketuarve besojnë se komuna e tyre ka plane të rregullta të auditimit që janë në pajtim me procedurat, 31% besojnë se komuna e tyre ka plane të rregullta të auditimit, ndonëse nuk janë në përputhje me procedurat, 16% besojnë se komuna e tyre ka plane të auditimit të cilat varen nga nevojat e menaxhimit, dhe 2% mendojnë se komuna e tyre nuk ka plane të tilla.


A ka komuna plane të auditimit?



14 MF (2008). *Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënia*, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L048_en.pdf

15 MF (2009). *Ligji për Auditimin e Brendshëm*, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009-128-eng.pdf>

Sa i përket pavarësisë profesionale të auditorit të brendshëm, 53% besojnë se ai/ajo është plotësisht i pavarur, 23% besojnë se është mjaftueshëm i pavarur, 14% besojnë se është i pavarur në formë të moderuar, dhe 5% besojnë se ai/ajo nuk është i pavarur. Edhe pjesëmarrësit e FG-ve shprehen se auditorët e brendshëm janë plotësisht të pavarur, edhe pse disa besojnë se ata kanë lidhje të ngushta me partitë politike.




Pjesëmarrësit e FG-ve gjithashtu tregojnë se disa komuna kanë auditorë të brendshëm të pamjaftueshëm pasi drejtorët e Njësisë të Auditimit të Brendshëm e nënvlerësojnë numrin e personelit të kërkuar kur i hartojnë planet e tyre strategjike. Pjesëmarrësit e FG-ve e ngritën çështjen e njohurive të auditorëve të brendshëm për procedurat e prokurimit duke pohuar se pa i njohur procedurat, është shumë e vështirë të auditohen proceset e prokurimit dhe të ofrohen rekomandime valide.

3.3. Bujqësia

Treguesi i Bujqësisë përbëhet nga dy nën-tregues siç është paraqitur në Figurën 3. Komunitat u vlerësuan me 1.97 pikë, gjë që e vendos performancën e tyre në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare'.

FIGURA 3: Treguesi i bujqësisë dhe nën-treguesit e tij



Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës “relativisht të mirë” në nën-treguesin e Tokës Bujqësore (disponueshmëria dhe përdorimi i tokës) që u vlerësua me 2.08 pikë. Megjithëse një numër i madh i të anketuarve pajtohen se toka bujqësore regjistrohet siç duhet, më shumë se gjysma e tyre besojnë se të dhënat e regjistrimeve janë të sakta vetëm deri në një farë mase. Për më tepër, rreth dy të tretat mendojnë se ndryshimet në përcaktimin e shënimit të përdorimit të tokës ndodhin në përputhje të plotë me procedurat në fuqi. Është interesante se pjesëmarrësit e FG-ve e ndajnë një pikëpamje të ndryshme. Ata besojnë se procesi shoqërohet nga dy probleme kryesore: përdoruesit e tokës shpesh nuk kërkojnë leje për ta ndryshuar shënimin e tokës dhe komunat zakonisht nuk kanë burime të mjaftueshme për t’i inspektuar shkeljet e tilla.

Rreth gjysma e të anketuarve deklarojnë se komuna e tyre ka një plan të përcaktuar mirë për mbrojtjen e tokës. Megjithatë, pjesëmarrësit e FG-ve theksojnë se plani kërkon që komuna të emërojë një inspektor për ta mbikëqyrur ekskluzivisht mbrojtjen e tokës bujqësore. Deri më sot asnjë komunë nuk e ka emëruar një inspektor të tillë.

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës ‘mesatare’ në nën-treguesin e Bashkëpunimit Bujqësor, i cili u vlerësua me 1.88 pikë. Rreth tre të katërtat e pjesëmarrësve vlerësojnë se bashkëpunimi në mes të drejtorive përkatëse në nivel komunal dhe Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është mesatar. Pjesëmarrësit e FG-ve theksojnë dy çështje që ndikojnë në bashkëpunimin. Problemi i parë ka të bëjë me afatet kohore të informatave nga MBPZHR për drejtoritë në lidhje me thirrjet për grante dhe subvencione. Vonesa në informata i lë komunat të papërgatitura për procesin që përfshin grumbullimin, shqyrtimin dhe administrimin e të gjitha aplikimeve për grante dhe subvencione. Problemi i dytë është se komunat mjaft shpesh neglizhohen nga donatorët ndërkombëtarë në ofrimin e shërbimeve të asistencës bujqësore. Donatorët kryesisht punojnë drejtpërdrejtë me fermerët, duke e përjashtuar komunën nga roli i mundësuesit dhe koordinatorit. Kjo qasje ngrit pyetjen mbi efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve.

Edhe gjetjet e FG-ve tregojnë se drejtoritë e bujqësisë kanë mungesë të personelit. Ka raste kur vetëm një nëpunës civil i dedikuar i administron të gjitha grantet dhe subvencionet bujqësore, kryen inspektime, ofron shërbime këshilluese, dhe ofron ndihmë administrative për aplikimin e fermerëve në emër të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Megjithatë, vihet re se pavarësisht nga rolet dhe përgjegjësitë e tyre në proces, zyrtarët komunalë të bujqësisë përjashtohen nga vlerësimi i hollësishëm i aplikimeve, i cili zhvillohet nga AZHB. Në fund, fermerët aplikues zakonisht i konsiderojnë zyrtarët komunalë përgjegjës dhe llogaridhënës për këtë proces.


TABELA 5: Bujqësia

	Drejtor/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
Komuna ka dëshmi të sakta të tokës bujqësore.	52,9%	35,7%	25,5%	38,0%
Plani për ruajtjen dhe mbrojtjen e tokës është i qartë dhe i përkufizuar mirë.	52,9%	46,4%	26,9%	42,1%
Komuna posedon një rregullore të përcaktuar qartë për dhënien me qira të tokës.	74,5%	82,1%	57,2%	71,3%
Procedurat zbatohen plotësisht për ndryshimin e shënimit të tokës sipas bazës ligjore.	74,5%	64,3%	49,8%	62,9%
Ekziston një nivel i lartë i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse.	37,3%	17,9%	12,2%	22,4%

3.4. Urbanizmi

Treguesi i Urbanizmit përbëhet nga katër nën-tregues siç janë paraqitur në Figurën 4. Komunitat u vlerësuan me 1.95 pikë, gjë që e vendos performancën e tyre në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare'.

FIGURA 4: Treguesi i urbanizmit dhe nën-treguesit e tij



Komunitat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Gjeodezisë dhe Kadastrës, i cili u vlerësua me 1.97 pikë. Teksa një pjesë e madhe e të anketuarve tregojnë se komunitat kanë një regjistër të pronës publike komunale, vetëm gjysma e tyre mendojnë se është i plotë dhe mirëmbahet rregullisht. Kur u pyetën nëse komuna e tyre ka një sistem për menaxhimin e pronës publike, shumica dërrmuese u përgjigj në formën pohore. Nga ana tjetër, shumica e të anketuarve po ashtu deklaruan se sistemi është ose joefektiv ose është në proces të funksionalizimit. Pjesëmarrësit e FG-ve tregojnë se komunitat në përgjithësi nuk kanë një inventar të pronës komunale, përveç në disa raste kur është zhvilluar me përkrahjen e projekteve të jashtme.

Teksa shumica theksojnë se komuna e tyre i ka të vendosura këto rregullore dhe standarde, rreth një e treta besojnë se rregulloret dhe standardet e tilla ose nuk janë në përputhje me ligjin përkatës ose nuk zbatohen. Në fund, më shumë se gjysma e të anketuarve konsiderojnë se zbatimi i këtyre dokumenteve rregullative është pjesërisht i rëndësishëm.

Çështje të ndryshme janë ngritur nga pjesëmarrësit e FG-ve gjatë diskutimeve mbi kontrollin dhe verifikimin e ndërtimeve të reja. Me reformat e reja të iniciuara nga MMPH-ja,¹⁶ një inspektor komunal është i obliguar të kryejë inspektime (vendndodhje, themele, strukturë, instalime elektrike dhe pajisje hidraulike) në faza të ndryshme të ndërtimit. Megjithatë, numri në dukje i pamjaftueshëm i inspektorëve është pengesë për procesin e inspektimit. Rrjedhimisht, investitorët e ndërtimeve shpesh devijojnë nga planet e miratuara. Në fund, pjesëmarrësit e FG-ve tregojnë se një numër i konsiderueshëm i inspektorëve kanë vetëm diploma të shkollës së mesme, gjë që i pengon në inspektimin e duhur të procesit të ndërtimit edhe kur bëjnë vizita në terren.

¹⁶ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2013). *Udhëzimi Administrativ për Standardet Minimale dhe Procedurat për Mbikëqyrjen e Inspektimit dhe Lëshimin e Certifikatës së Banimit*

Pjesëmarrësit e FG-ve besojnë gjithashtu se Projektligji për Planifikimin Hapësinor ofron më shumë liri veprimi për investitorët për të konfirmuar se ndërtimi i tyre është në përputhje me planin teknik. Kjo u shërben interesave të investitorëve dhe mjaft shpesh çon në devijime nga plani teknik. Pjesëmarrësit e FG-ve gjithashtu theksojnë se as projektligji ende nuk e ka rregulluar në mënyrë të qartë statusin e ndërtesave tashmë të ndërtuara. Kjo e bën mjaft problematik miratimin teknik dhe regjistrimin në sistemin kadastral. Përfundimisht, ata deklaruan se shumica e ndërtesave të reja nuk janë ndërtuar në përputhje me standartet ekzistuese të efikasitetit, gjë që është rezultat i paaftësisë komunale për të kryer inspektime efikase.

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Mbrojtjes së Mjedisit duke u vlerësuar me 1.87 pikë. Sa i përket planifikimit mjedisor, më shumë se dy të tretat e të anketuarve tregojnë se komuna e tyre ka miratuar një plan mjedisor dhe se plani po zbatohet. Nga ana tjetër, vetëm rreth një e treta besojnë se vendimet ekzekutive që përfshijnë çështjet e mjedisit rrjedhin nga plani mjedisor. Përveç kësaj, rreth gjysma e të anketuarve pohojnë se komuna e tyre ka një nivel të moderuar të ekspertizës për të hartuar këtë lloj dokumenti strategjik, gjë që mund të shihet si njëra prej arsyeve pse disa komuna ende nuk e kanë hartuar planin.

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Planifikimin Urban duke u vlerësuar me 1.72 pikë. Ligji për Planifikimin Hapësinor¹⁷ parashikon që planifikimi për tërë territorin e komunave do të rregullohet përmes dokumenteve në vijim: Planet Zhvillimore të Komunës (PZhK), Hartat Komunale të Ndarjeve Zonale (HKNZ), dhe Planet e Detajuara Rregullative (PDRr).

Sa i përket PZhK-së, më shumë se dy të tretat e të anketuarve besojnë se komuna e tyre posedon një nivel të moderuar të ekspertizës për hartimin e planeve të tilla. Një pjesë e ngjashme thotë se PZhK-ja zbatohet pak ose pjesërisht. Pjesëmarrësit e FG-ve e konfirmojnë këtë pohim. Sipas tyre, PZhK-ja neglizhohet me të madhe nga ekzekutivi, edhe pse në parim, pas statutit komunal, PZhK-ja duhet të konsiderohet si dokumenti më i rëndësishëm për planifikimin urban. Gjithashtu duket se nuk ka lidhje në mes të planifikimit të buxhetit dhe PZhK-së. Rrjedhimisht, objektivat e përcaktuara në këto plane nuk mund të arrihen me buxhetet ekzistuese komunale. Vlen të përmendet se në disa komuna PZhK-ja tashmë ka skaduar.

Siç u tha më parë, Ligji obligon secilën komunë të krijojë një HKNZ si një dokument shumë-sektorial që përmban grafikë, foto, harta dhe tekst për të përcaktuar në detaje llojin, destinacionin dhe përdorimin e hapësirës. Gjetjet e FG-ve tregojnë se komunat nuk kanë arritur të përpilojnë harta të tilla. Megjithëse Ligji aktual hyri në fuqi në vitin 2013, legjislacioni sekondar i nevojshëm për ta funksionalizuar këtë proces nuk ishte miratuar deri në vitin 2016. Disa komuna, me përkrahjen e organizatave ndërkombëtare, kohët e fundit kanë filluar të punojnë për HKNZ-të e tyre. Duket se ndihma e jashtme do të jetë e nevojshme për të gjitha komunat. Dy të tretat e të anketuarve pohojnë se niveli i ekspertizës për krijimin e hartave të tilla është joadekuat. Në mungesë të HKNZ-ve, shumë komuna ende u referohen Planeve Urbane Zhvillimore .

17 MMPH (2013), *Ligji për Planifikimin Hapësinor*, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20spatial%20planning.pdf>


TABELA 6: Urbanizmi

	Drejtor/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
PZhK-të				
Komuna ka një nivel të lartë të ekspertizës në lidhje me hartimin e planit zhvillimor.	34,4%	28,6%	11,4%	24,8%
Në mungesë të ekspertizës së mjaftueshme, komuna ka kontraktuar një kompani projektuese për përgatitjen e PZhK-së.	71,9%	68,6%	60,9%	67,1%
Vendimet ekzekutive tërësisht bazohen në PZhK.	42,2%	28,6%	17,3%	29,4%
Plani urbanistik komunal				
Komuna ka një nivel të lartë të ekspertizës për përpilimin e hartave të ndarjeve zonale.	28,1%	20,0%	12,5%	20,2%
Në mungesë të ekspertizës së mjaftueshme, komuna ka kontraktuar një kompani projektuese për përgatitjen e planit.	65,6%	60,0%	54,6%	60,1%
Vendimet ekzekutive tërësisht bazohen në PZhK.	50,0%	34,3%	17,7%	34,0%
Rregulloret dhe vendimet për ndërtimet, standardet për kontrollin e ndërtimeve				
Ekzistojnë rregullore ose standarde dhe ato plotësisht respektohen në përputhje me legjislacionin.	54,7%	42,9%	20,7%	39,4%
Zbatimi i tyre në vendimmarrjen ekzekutive është plotësisht kuptimplotë.	49,2%	38,2%	22,5%	36,7%
Mekanizmat e zbatimit të rregulloreve, inspektimi i ndërtimeve				
Mekanizmat ligjorë për zbatimin e rregulloreve dhe standardeve të ndërtimit janë plotësisht të përcaktuar dhe të qartë.	50,0%	44,6%	26,2%	40,3%
Burimet njerëzore janë plotësisht të mjaftueshme për zbatimin e rregulloreve dhe standardeve të ndërtimit.	28,4%	26,8%	19,9%	25,0%
Plani i mbrojtjes mjedisore				
Komuna ka plane të miratuara për mbrojtjen mjedisore dhe ato zbatohen me procedurë të rregullt.	76,6%	77,1%	55,7%	69,8%
Komuna ka nivel të lartë të ekspertizës për zhvillimin e planeve për mbrojtjen mjedisore.	4,7%	14,3%	24,0%	14,3%
Vendimet ekzekutive tërësisht bazohen në planin e mbrojtjes së mjedisit.	40,6%	25,7%	15,1%	27,2%
Menaxhimi dhe evidentimi i pronës publike komunale				
Regjistri i pronës publike komunale është në funksion, është i plotë, dhe rregullisht përditësohet dhe mirëmbahet .	50,9%	49,3%	31,0%	43,7%
Komuna ka një sistem mjaft efikas për menaxhimin e pronës publike komunale.	25,5%	29,0%	18,1%	24,2%

3.5. Të drejtat e njeriut

Treguesi i të Drejtave të Njeriut përbëhet nga tre nën-tregues siç janë paraqitur në Figurën 5. Komunitat u vlerësuan me 1.92 pikë, gjë që e vendos performancën e tyre në nivelin e lartë të shkallës ‘mesatare’.

FIGURA 5: Treguesi i të drejtave të njeriut dhe nën-treguesit e tij



Komunitat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës “relativisht të mirë” në nën-treguesin e Komunikimit dhe Gjuhës duke u vlerësuar me 2.11 pikë. Në të vërtetë, komunikimi dhe përkthimi i mirë i dokumenteve në të gjitha gjuhët zyrtare është një parakusht për trajtimin e barabartë të komuniteteve. Pothuajse të gjithë të anketuarit besojnë se dokumentet zyrtare përkthehen në gjuhët zyrtare. Megjithatë, vetëm një e treta e tyre konsiderojnë se përkthimi ndodh rregullisht. Pjesëmarrësit e FG-ve tregojnë se çështjet e përkthimit janë më të theksuara në komunitat me shumicë serbe.

Komunitat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës ‘mesatare’ në nën-treguesin e Komuniteteve dhe Kthimit duke u vlerësuar me 1.80 pikë. Edhe pse shumica dërrmuese e të anketuarve tregojnë se komuna e tyre e ka themeluar Zyrën për Komunitete dhe Kthim, dy të tretat tregojnë se kjo Zyrë ose nuk është funksionale ose është pjesërisht funksionale. Në përgjithësi, përgjegjësitë dhe funksionet e këtyre zyrave duket se janë të pamjaftueshme ose fare nuk janë të qarta. Shumica dërrmuese e të anketuarve konfirmojnë se ekzistojnë mekanizma të qartë për vendimmarrje mbi çështjet e pakicave.


Komunitat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës ‘mesatare’ në nën-treguesin e Kornizës Ligjore për të Drejtat e Njeriut duke u vlerësuar me 1.78 pikë. Anketa tregon se rreth gjysma e të anketuarve kanë njohuri të arsyeshme për legjislacionin në vijim: Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligji për Avokatin e Popullit. Një numër i ngjashëm i të anketuarve besojnë se komuna e tyre ka një sistem të qartë për informimin e qytetarëve të saj për ndryshimet në legjislacionin që rregullon kornizën ligjore për të drejtat e njeriut.

TABELA 7: Të drejtat e njeriut

	Drejtorë/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
Korniza ligjore për të drejtat e njeriut				
Komuna ka njohuri të avancuara për miratimin e pakos ligjore për të drejtat e njeriut: Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, dhe Ligji për Avokatin e Populli .	17,9%	23,1%	14,0%	18,3%
Komuna ka një sistem plotësisht të qartë për informimin e qytetarëve të saj në lidhje me ndryshimet në legjislacion.	20,5%	28,6%	16,6%	21,9%
Strukturat komunale për komunitete dhe kthim				
Komuna ka themeluar një Zyrë tërësisht funksionale për Komunitete dhe Kthim.	75,0%	37,5%	36,9%	49,8%
Strukturat komunale për Komunitete dhe Kthim kanë një plan pune.	75,0%	81,3%	66,1%	74,1%
Përgjegjësitë, funksionet dhe raportimi i tyre janë plotësisht të qarta.	50,0%	31,3%	14,4%	31,9%
Ekziston një bashkëpunim ndër-sektorial i nivelit të lartë.	50,0%	18,8%	13,3%	27,3%
Korniza për vendimet mbi çështjet e pakicave				
Ka një mekanizëm plotësisht të qartë për vendimmarrje mbi çështjet e pakicave	58,3%	43,8%	29,9%	44,0%
Proceset e vendimmarrjes janë në përputhje me legjislacionin dhe zbatohen plotësisht.	80,0%	62,5%	48,1%	63,5%
Ka nivel të lartë të informimit publik mbi kthimin dhe të drejtat e komuniteteve.	34,4%	29,7%	13,7%	25,9%
Dokumentet zyrtare që lëshohen nga komuna gjithmonë përkthehen.	28,1%	32,8%	29,5%	30,2%
Komuna e ka miratuar rregulloren për përdorimin e gjuhëve.	71,9%	68,8%	66,1%	68,9%

3.6. Prokurimi komunal

Treguesi i Prokurimit Komunal është i përbërë nga tre nën-tregues siç janë paraqitur në Figurën 6. Komunitat kanë rezultuar me 1.91 pikë, gjë që e vendos performancën e tyre në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare'.

FIGURA 6: Treguesi i prokurimit komunal dhe nën-treguesit e tij

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës “relativisht të mirë” në nën-treguesin e Planifikimit të Prokurimit duke u vlerësuar me 2.06 pikë. Më shumë se dy të tretat e të anketuarve deklaruan se komuna e tyre harton plane vjetore të prokurimit, ndërsa rreth gjysma e tyre i vlerësojnë si “mesatare” kapacitetet e personelit për t’i hartuar këto plane.

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës ‘mesatare’ në nën-treguesin e Priorizimit të Projekteve duke u vlerësuar me 1.85 pikë. Gati gjysma e të anketuarve besojnë se komuna e tyre ka mekanizma të mjaftueshëm për identifikimin dhe përzgjedhjen e projekteve. Një proporcioni i njëjtë gjithashtu beson se procesi i përzgjedhjes është relativisht objektiv. Për dallim, më shumë se gjysma mendojnë se personeli ka shkathtësi të moderuara dhe u mungon përvoja e nevojshme për përgatitjen e projekteve.

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës ‘mesatare’ në nën-treguesin e Etikës së Prokurimit duke u vlerësuar më pak, me 1.81 pikë. Perceptimi i përgjithshëm në mesin e të anketuarve është se kapacitetet për ta siguruar zbatimin e parimeve etike dhe të kodit të sjelljes për ekipin e prokurimit dhe nivelin e koordinimit me nivelin qendror, janë në nivel të moderuar.

Pjesëmarrësit e FG-ve japin përshtypje të ndryshme. Ata pajtohen për disa çështje që ndikojnë në procesin e prokurimit në nivel komunal. Së pari, është shumë e zakonshme që zyrtarët e prokurimeve publike të përpunojnë shumë kontrata të prokurimit në të njëjtën kohë. Kjo krijon hapësirë për gabime dhe mund të shkaktojë shkelje procedurale. Së dyti, kur zyrtarët e prokurimit marrin një vendim, ata nuk u referohen mjaftueshëm neneve përkatëse të ligjit të prokurimit dhe dokumenteve tjera ligjore. Kjo rezulton në paqartësi dhe i ‘stimulon’ operatorët ekonomikë për të parashtruar ankesa. Përveç kësaj, pjesëmarrësit e FG-ve treguan se ‘ekspertët’ e emëruar për t’i hartuar specifikimet teknike të një kontrate të caktuar komunale zakonisht kanë tendencë për të favorizuar ose diskriminuar një ose më shumë operatorë ekonomikë. Në mungesë të çmimeve zyrtare të referencës, ka raste kur kontrata publike u jepet ofertuesve me çmime të paarsyeshme.


Ka gjithashtu probleme me zbatimin e kontratave. Sipas pjesëmarrësve të FG-ve, nuk ka vullnet në mesin e menaxherëve të kontratave për t’i penalizuar operatorët ekonomikë të cilët dështojnë në përmbushjen e kushteve dhe afateve të kontratës. Menaxherët e kontratave zakonisht dorëzojnë raporte pozitive, edhe pse cilësia e punimeve nuk është në përputhje me specifikimet e shënuara në dosjen e tenderit. Për më tepër, kontratat nuk monitorohen siç duhet, gjë e cila, nga ana tjetër, shpie në një cilësi të dobët të punës. Në fund, pjesëmarrësit e FG-ve nënvizojnë faktin se nuk ka kolegjalitet të zyrtarëve të prokurimit në AKK, prandaj bashkëpunimi në të mes komunave mezi mbahet në një minimum.

TABELA 8: Prokurimi komunal

	Drejtorë/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
Ka mekanizma të avancuar për identifikimin dhe përzgjedhjen e projekteve.	33,0%	32,6%	14,4%	26,7%
Kriteret e përzgjedhjes së projekteve janë plotësisht objektive.	39,4%	30,4%	11,4%	27,1%
Shkathtësitë dhe përvojat për përgatitjen e projekteve janë të një niveli të lartë dhe ka ekspertizë të gjerë.	61,7%	43,5%	24,7%	43,3%
Parimet e etikës, Kodi i Sjelljes				
Komuna ka kapacitete adekuatë për ta siguruar zbatimin e parimeve etike dhe të kodit të sjelljes për ekipin e prokurimit.	43,6%	32,6%	12,9%	29,7%
Koordinimi me nivelin qendror është i mirë.	51,1%	45,7%	17,7%	38,1%
Planifikimi vjetor i prokurimit				
Komuna ka planin e prokurimit që përgatitet në baza vjetore.	77,7%	73,9%	49,4%	67,0%
Komuna ka nivel të lartë të kapaciteteve për përpilimin dhe zbatimin me saktësi të planeve të prokurimit.	47,9%	39,1%	22,5%	36,5%

3.7. Arsimi

Treguesi i Arsimit përbëhet nga katër nën-tregues siç janë paraqitur në Figurën 7. Komunat u vlerësuan me 1.77 pikë, gjë që e vendos performancën e tyre në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare'.

FIGURA 7: Treguesi i arsimit dhe nën-treguesit e tij

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Arsimit Para-shkollor duke u vlerësuar me 1.94 pikë. Rezultatet e anketës tregojnë se rreth dy të tretat e të anketuarve pohojnë se komuna e tyre ka licencuar institucione të arsimit para-shkollor. Megjithatë, pjesëmarrësit e FG-ve besojnë se numri nuk është i mjaftueshëm për t'i plotësuar nevojat e qytetarëve. Më shumë se dy të tretat e pjesëmarrësve të anketës janë dakord se infrastruktura në këto institucione mirëmbahet në mënyrë të moderuar.

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Personelit Mësimdhënës duke u vlerësuar me 1.87 pikë. Ky nën-tregues bën matjen e numrit dhe cilësisë së personelit mësimdhënës në shkollat fillore dhe të mesme. Mbi dy të tretat e të anketuarve ndajnë mendimin se shumica e mësimdhënësve janë të kualifikuar. Pyetja mbi nivelin e njohurive me trendet e fundit në zhvillimin e politikave të arsimit (legjislacioni, dokumentet e kurrikulës dhe të ngjashme) i ndau të anketuarit e pyetësorit: gjysma beson se mësimdhënësit janë të njoftuar me tendencat e arsimit, ndërsa gjysma tjetër pretendon të kundërtën.

Gjetjet e FG-ve sugjerojnë se rekrutimi i mësimdhënësve dhe ri-caktimi i atyre ekzistues është i mbushur me parregullsi. Numri dhe përbërja e komisioneve të rekrutimit ndryshon nga një komunë në tjetrën, duke e bërë procesin e rekrutimit jo uniform dhe të cenueshëm ndaj pretendimeve për padrejtësi dhe madje keqmenaxhim. Për më tepër, që nga brezi i fundit i klasës së 13-të të shkollës së mesme të diplomuar në vitin 2014, disa mësimdhënës kanë pësuar reduktim në orët e mësimi. Në disa raste, në vend të ri-caktimit të këtyre mësimdhënësve në pozita të rregullta me orar të plotë, shkollat e mesme hapin vende të reja pune. Natyrisht, kjo krijon pakënaqësi në mesin e personelit mësimor ekzistues. Një çështje tjetër me implikime në politika, është numri në rënie i nxënësve në shkolla, rezultat i shkallës më të ulët të lindjeve. Kjo, gjithashtu, ka lënë disa mësimdhënës pa orë të plota mësimore dhe ka shkaktuar teprica.

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës "relativisht të dobët" në nën-treguesin e Arsimit Fillor dhe të Mesëm duke u vlerësuar me 1.43 pikë. Sipas pjesëmarrësve të FG-ve, shkollat fillore dhe të mesme nuk kanë objekte të përshtatshme, si laboratorë për kiminë, fizikën, biologjinë dhe orët e tjera të shkencës. Kohëve të fundit disa laboratorë janë krijuar me ndihmën e komunitetit të donatorëve. Të anketuarit janë neutralë për mirëmbajtjen dhe riparimin e infrastrukturës së përgjithshme. Ndërkohë, mangësitë në shërbimet shëndetësore dhe këshilluese perceptohen si çështje serioze në shkollat fillore dhe të mesme, pasi që nuk ka kontrole të rregullta. Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se komunat përgjithësisht nuk arrijnë ta promovojnë rëndësinë e zhvillimit në fëmijëri të hershme.

Për ta përmirësuar pjesëmarrjen dhe për ta zvogëluar shkallën e braktisjes,¹⁸ komunat janë të obliguara me Ligjin për Arsimin Parauniversitar¹⁹ që të ofrojnë transport të sigurt, efikas dhe pa pagesë për nxënësit që jetojnë të paktën katër kilometra larg shkollës. Megjithëse rreth tre të katërtat e të anketuarve besojnë se shumica e shkollave e respektojnë këtë dispozitë ligjore, pjesëmarrësit e FG-ve theksojnë se ndonjëherë transporti nuk ofrohet për shkak të procesit të prokurimit. Përveç kësaj, më shumë se dy të tretat e të anketuarve mendojnë se komunat nuk kanë arritur të krijojnë ekipe funksionale për të parandaluar braktisjen dhe mos-regjistrimin sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës "relativisht të dobët" në nën-treguesin e Rregulloreve të Shkollës duke u vlerësuar me 1.37 pikë. Ky nën-tregues shqyrton tre rregullore/kode si në vijim: Rregullat e Procedurës për Institucionet Para-shkollore, të Arsimit Fillor dhe të Mesëm; Kodi i Sjelljes; dhe Protokoli

¹⁸ Shkalla e braktisjes së shkollës në arsimin e detyruar në vitin shkollor 2016/17 është 0.07%, ndërsa në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas është 26 herë më e lartë - 1.85%.

¹⁹ Kuvendi i Kosovës (2011), Ligji për Arsimin Parauniversitar, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,666>

i Rregullimit për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar. Teksa shumë të anketuar në anketë pohojnë se dy të parat janë miratuar, ka konsensus se zbatimi i tyre ose nuk monitorohet ose zhvillohet në baza ad hoc. Nga ana tjetër, mungon njohuria mbi dhe zbatimi i rregullores për, parandalimin e dhunës.

TABELA 9: Arsimi


	Drejtorë/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
Rregulloret e Shkollës				
Rregullorja e punës për institucionet arsimore është miratuar.	87,1%	81,8%	83,0%	84,0%
Komuna e mbikëqyrë rregullisht zbatimin e rregullores.	57,4%	48,1%	40,4%	48,7%
Kodi i Sjelljes dhe masat disiplinore për nxënësit e shkollës së mesme janë aprovuar.	79,0%	78,8%	74,9%	77,6%
Komuna i shqyrton rregullisht politikat e lidhura me Kodin e Sjelljes.	57,1%	53,8%	42,4%	51,1%
Jam i informuar, dhe e zbatoj plotësisht rregulloren 21/2013 mbi parandalimin dhe referimin e dhunës në institucione arsimore parauniversitare	46,8%	30,3%	17,0%	31,4%
Arsimi fillor dhe i mesëm				
Komuna ka shënuar zona të mbulimit me shkolla.	83,9%	78,8%	78,2%	80,3%
Ka nivel të lartë të mirëmbajtjes dhe riparimit në ndërtesat shkollore.	32,3%	30,3%	13,7%	25,4%
Komuna ofron transport për nxënësit e shkollave të mesme dhe për mësimdhënësit , që jetojnë më shumë se 4 km larg shkollës.	6,5%	12,1%	10,3%	9,6%
Komuna ofron arsim special në bazë të ligjit.	62,9%	72,7%	58,7%	64,8%
Komuna e ka zbatuar udhëzimin administrativ mbi krijimin e ekipeve për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkolla, dhe ekipet gjithmonë kanë qenë funksionale?	45,9%	44,9%	15,9%	35,6%
Arsimi para-shkollor				
Komuna ka caktuar zona të mbulimit nga niveli para-shkollor.	74,2%	72,7%	67,5%	71,5%
Në komunë ka institucione parashkollore dhe të gjitha janë të licencuara.	66,1%	63,6%	50,2%	60,0%
Në komunë ka zyrtarë që e mbulojnë arsimin para-shkollor.	66,1%	69,7%	59,8%	65,2%

Komuna e pranon dhe e promovon rëndësinë e zhvillimit në fëmijëri të hershme.	33,9%	36,4%	18,5%	29,6%
Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të arsimit parashkollor janë të nivelit të lartë.	33,9%	30,3%	14,8%	26,3%

3.8. Shërbimet publike dhe ato të emergjencave

Treguesi i Shërbimeve Publike dhe atyre të Emergjencave përbëhet nga katër nën-tregues siç janë paraqitur në Figurën 8. Komunitat janë vlerësuar me 1.72 pikë, gjë që e vendos performancën e tyre në nivelin e ulët të shkallës 'mesatare'.

FIGURA 8: Treguesi i shërbimeve publike dhe atyre të emergjencave dhe nën-treguesit e tij



Komunitat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Emergjencave duke u vlerësuar me 1.84 pikë. Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri²⁰ specifikon se secila komunë është e detyruar të zhvillojë një plan për mbrojtjen nga zjarri, të bazuar në një vlerësim të rreziqeve nga zjarri dhe në përputhje me ligjet përkatëse të cilat e adresojnë mbrojtjen, sigurinë, mjedisin dhe fatkeqësitë. Shumica e të anketuarve pajtohen se komunitat e kanë planin e mbrojtjes nga zjarri, ndonëse rreth dy të tretat e të anketuarve konsiderojnë se plani nuk zbatohet rregullisht. Më shumë se dy të tretat e të anketuarve flasin për nivel të moderuar të ekspertizës në hartimin e planeve të tilla. Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri gjithashtu parasheh që komunitat do të kenë njësi të zjarrfikësve me numër të mjaftueshëm personeli. Teksa një numër i konsiderueshëm i të anketuarve dhe pjesëmarrësve të FG-ve tregojnë se komuna e tyre ka një njësi të zjarrfikësve, vetëm një e treta pajtohen se numri i personelit është në përputhje me Ligjin, duke vënë në dukje se disa njësi të zjarrfikësve nuk kanë as pajisje adekuate. Teksa shumica e të anketuarve të anketës insistojnë se komuna e tyre ka Njësinë e Menaxhimit të Shërbimeve Zjarrfikëse, vetëm një e treta e tyre konsiderojnë se kjo njësi ofron shërbime adekuate kur paraqitet nevoja. Disa komuna gjithashtu duket se kanë kontrata 'pasive' me kompani private për trajtimin e situatave emergjente.

²⁰ Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri (2011), <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20fire%20protection.pdf>

Një çështje tjetër e ngritur nga pjesëmarrësit e FG-ve është mungesa e qartësisë në përgjegjësitë e zjarrfikësve ndaj komunës dhe Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave. Vartësia e njësive të zjarrfikësve nga institucionet lokale dhe qendrore krijon burokraci të panevojshme.

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Mirëmbajtjes së Rrugëve Publike duke u vlerësuar me 1.65 pikë. Të anketuarit pajtohen se rrugët publike mirëmbahen në mënyrë të moderuar, për shkak të fondeve dhe burimeve njerëzore të kufizuara. Një e treta pohon se komuna e tyre shpesh ose rregullisht e mat mendimin e qytetarëve në lidhje me mirëmbajtjen e rrugëve publike. Pjesëmarrësit e FG-ve deklarojnë se operatorët ekonomikë, përgjegjës për mirëmbajtjen e rrugëve publike, kanë lidhje të ngushta me politikanët. Si rezultat, shumë shpesh ata devijojnë nga marrëveshjet kontraktuale dhe i lënë rrugët publike me mirëmbajtje nën standard.

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Ujit, Kanalizimeve dhe Mbeturinave dhe nën-treguesin e Transportit Publik, duke u vlerësuar me 1.60 dhe respektivisht me 1.59 pikë. Ndërmarrjet publike komunale dhe rajonale janë përgjegjëse për furnizimin me ujë, për kanalizimet dhe menaxhimin e mbeturinave. Teksa shumica dërrmuese e të anketuarve deklarojnë se komuna e tyre ka mekanizma për të matur cilësinë e shërbimeve publike, vetëm një pjesë të vogël besojnë se këto mekanizma janë të avancuara. Kontrolli i cilësisë duket se është disi më i mirë, pasi më shumë se dy të tretat e të anketuarve deklarojnë se komuna e tyre kryen inspektime sanitare për shërbimet e lartpërmendura.

Gjetjet e FG-ve zbulojnë sfida të tjera që lidhen me furnizimin me ujë, kanalizimet dhe menaxhimin e mbeturinave. Më urgjentja është mungesa e koordinimit në mes të kompanive rajonale dhe komunave në ofrimin e furnizimit me ujë.

Pjesëmarrësit e FG-ve theksojnë se komunat dhe kompanitë rajonale nuk i koordinojnë gjithmonë aktivitetet e tyre, gjë që shpie në mundësi të humbura për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe për grumbullimin e të hyrave, për të mos e përmendur përdorimin joefikas të fondeve. Gjithashtu duket se ka paqartësi për rolin e komunave në furnizimin me ujë. Pjesëmarrësit e FG-ve pretendojnë se qytetarët shpesh fajësojnë komunat për furnizim të dobët me ujë, ndonëse vetë komunat nuk janë përgjegjëse për furnizimin me ujë. Në fund, shumica e komunave nuk e kanë një nëpunës civil komunal të caktuar për t'u marrë me menaxhimin e mbeturinave, edhe pse ato janë të obliguara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.²¹ Disa pjesëmarrës nxjerrin në pah raste kur kompanitë e menaxhimit të mbeturinave kanë krijuar deponi ilegale me efekte shkatërruese për mjedisin.

Sa i përket transportit publik, shumica e të anketuarve deklarojnë se komuna e tyre ka një plan të qartë të transportit publik. Rreth dy të tretat e të anketuarve thonë se kapacitetet njerëzore për të zhvilluar një plan të tillë duket se janë në një nivel të moderuar. Licencimi i kompanive të transportit publik duket se është disi problematik: një numër i konsiderueshëm i të anketuarve besojnë se kompanitë që ofrojnë shërbime të transportit publik nuk janë të licencuara. Të anketuarit besojnë se orari i linjave të caktuara të transportit respektohet në të shumtën e rasteve. Pjesëmarrësit e FG-ve përgjithësisht besojnë se sistemi i transportit publik është joadekuat.

21 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008), *Ligji për Vetëqeverisjen Lokale*, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_en.pdf

TABELA 10: Shërbimet publike dhe ato të emergjencave


	Drejtor/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
Furnizimi me ujë, kanalizimet, dhe mbeturinat				
Furnizimi me ujë, kanalizimet dhe mbeturinat menaxhohen plotësisht nga ndërmarrjet publike në komunë.	45,5%	42,1%	24,7%	37,4%
Ka mekanizma të avancuar për matjen e cilësisë së shërbimeve në komunë.	13,6%	7,0%	5,2%	8,6%
Komuna e kryen inspektimin sanitar si kontroll të cilësisë për këto shërbime.	80,9%	68,4%	59,4%	69,6%
Shërbimi zjarrfikës				
Njësia e Menaxhimit të Shërbimeve Zjarrfikëse funksionon në komunë dhe ofron shërbim adekuat.	38,2%	29,8%	16,6%	28,2%
Ka një brigadë të tillë në komunë dhe numri i zjarrfikësve është në përputhje me Ligjin.	32,7%	15,8%	16,6%	21,7%
Planet e reagimit emergjent dhe planet e mbrojtjes nga zjarri				
Ekziston një plan për reagimin ndaj emergjencave dhe mbrojtjen nga zjarri dhe zbatohet në baza të rregullta, dhe vendimet ekzekutive bazohen në të.	61,8%	49,1%	29,2%	46,7%
Komuna ka nivel të lartë të ekspertizës për të zhvilluar në detaje një plan realist dhe konkret për reagimin ndaj emergjencave dhe për mbrojtjen nga zjarri.	30,0%	19,3%	15,5%	21,6%
Përdorimi efikas i resurseve ndaj/drejt reagimeve emergjente është në nivel të lartë.	16,4%	5,3%	7,4%	9,7%
Ndërmarrjet Publike të Pavarura Komonale				
Ekziston një Komision Komunal i Palëve të Interesit në komunë dhe është gjithmonë funksional.	37,5%	25,7%	14,0%	25,7%
Ka një Bord të Drejtorëve dhe është gjithmonë funksional.	52,8%	45,7%	23,2%	40,6%
Është miratuar plani i biznesit për ndërmarrjet e pavarura komunale (NPK) nga bordi i drejtorëve.	40,3%	31,4%	37,3%	36,3%
Komisioni i Auditimit është themeluar.	63,9%	48,6%	53,9%	55,4%
Janë emëruar zyrtarët afaristë të ndërmarrjeve të pavarura komunale (NPK) nga bordi i drejtorëve.	33,3%	37,1%	35,8%	35,4%
Është miratuar kodi etik i ndërmarrjeve të pavarura komunale (NPK)	38,9%	28,6%	28,4%	32,0%
Transporti publik komunal dhe licencimi i tyre				
Komuna ka një plan plotësisht të qartë për rregullimin e transportit publik.	34,7%	17,1%	10,3%	20,7%

Kapacitetet e burimeve njerëzore për hartimin e politikave për transportin lokal janë në nivel të lartë.	22,2%	20,0%	13,3%	18,5%
Të gjitha kompanitë që kryejnë transportin janë të licencuara.	50,0%	34,3%	14,8%	33,0%
Respektohet gjithmonë orari i linjave të transportit.	44,4%	22,9%	15,1%	27,5%
Mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe hapësirave publike				
Rrugët lokale dhe hapësirat publike mirëmbahen në nivel të lartë.	17,9%	14,3%	8,5%	13,6%
Komuna ka një sistem të qëndrueshëm për të monitoruar dhe vlerësuar mirëmbajtjen e rrugëve dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike.	74,6%	62,9%	56,8%	64,8%
Komuna rregullisht e mat opinionin publik në lidhje me prioritetet për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe hapësirave publike.	36,6%	48,6%	20,7%	35,3%

NDËRMARRJET PUBLIKE


Kur u pyetën nëse Ndërmarrjet e Pavarura Komunale (NPK) kanë një bord të drejtorëve, 76% u përgjigjën pozitivisht dhe 24% u përgjigjën negativisht. Pjesëmarrësit e FG-ve theksojnë se anëtarët e bordit zakonisht emërohen përmes ndikimit politik dhe se nuk ka dallim të qartë në mes të bordit dhe drejtorëve ekzekutivë.

A ka bord drejtorësh në Ndërmarrjet Publike Komunale?




Kur u pyetën nëse ka një Komision Komunal të Palëve të Interesit, 70% u përgjigjën pozitivisht dhe 30% negativisht. Ata që u përgjigjën pozitivisht pajtohen se ai vepron në mënyrë të parregullt.

A ka një Komisioni Komunal të Aksionarëve në komunë?



Grafiku i mëposhtëm i tregon gjetjet e disa pyetjeve dikotome që prekin ndërmarrjet publike në nivel komunal. Sipas 65% të të anketuarve, komuna e tyre ka një sistem të qëndrueshëm për monitorim-indhe vlerësimin e mirëmbajtjes së rrugëve dhe hapësirave publike, 19% pretendojnë të kundërtën, ndërsa 17% të mbetur nuk e dinë. Kur u pyetën nëse komuna ka themeluar një Komision të Auditimit, 55% u përgjigjën pozitivisht, 12% negativisht, ndërsa 32% nuk janë në dijeni.


Nga ana tjetër, 36% e të anketuarve tregojnë se plani i biznesit për NPK është miratuar nga bordi i drejtorëve, 19% pohojnë se nuk është miratuar, ndërsa 45% nuk janë në dijeni. Të anketuarit kanë pikëpamje shumë të ngjashme rreth emërimit të zyrtarëve afaristë në NPK nga bordi i drejtorëve, teksa 35% besojnë se zyrtarët afaristë janë emëruar nga bordi i drejtorëve, 19% konsiderojnë se nuk janë emëruar, ndërsa 46% nuk janë në dijeni. Në fund, 32% e të anketuarve deklarojnë se kodi i etikës për NPK është miratuar, 16% pohojnë të kundërtën, ndërsa shumica, 52%, nuk janë në dijeni.



3.9. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Treguesi i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale përbëhet nga katër nën-tregues siç janë paraqitur në Figurën 9. Komunat u vlerësuan me 1.68 pikë, gjë që e vendos performancën e tyre në nivelin e ulët të shkallës 'mesatare'.

FIGURA 9: Treguesi i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe nën-treguesit e tij



Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Aktivitetit të Shëndetësisë Private duke u vlerësuar me 1.83 pikë. Shumica dërrmuese e të anketuarve janë të informuar në lidhje me klinikat private të kujdesit shëndetësor që veprojnë në komunën e tyre, dhe vetëm gjysma e tyre deklarojnë se kanë një bazë të plotë të të dhënave të institucioneve private të kujdesit shëndetësor. Pavarësisht ekzistencës së një komisioni komunal të inspektimit, përafërsisht dy të tretat e të anketuarve besojnë se ose nuk është funksional ose i kryen aktivitetet me raste.

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Shërbimeve Sociale duke u vlerësuar me 1.73 pikë. Gati gjysma e të anketuarve besojnë se komuna e tyre ofron shërbime të kënaqshme sociale dhe familjare. Rreth gjysma e të anketuarve pajtohen me deklaratën se komunat shpesh ofrojnë shërbime sociale shtesë, varësisht nga nevojat e qytetarëve. Sipas pothuajse gjysmës së të anketuarve, bashkëpunimi me OJQ-të në ofrimin e shërbimeve sociale duket se është i moderuar ose i lartë. Megjithatë, pjesëmarrësit e FG-ve shfaqin disa shqetësime për mënyrën se si ka ndodhur decentralizimi i shërbimeve sociale. Ata mendojnë se ofrimi i shërbimeve sociale duhet të shoqërohet me decentralizimin e financave, përndryshe pengohet ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare për qytetarët.

Gjetjet e FG-ve për ndihmën sociale tregojnë se ka një mbivendosje të përgjegjësisë ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS). Struktura aktuale me të cilën MPMS menaxhon buxhetin dhe QPS-të, siguron shërbimet, ndikon në efikasitetin dhe efektivitetin e ofrimit të shërbimeve. Pjesëmarrësit e FG-ve deklarojnë më tej se ka shumë raste të qytetarëve që e manipulojnë sistemin me ç'rast përfitojnë nga ndihma sociale edhe pse nuk kanë të drejtë.

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës 'mesatare' në nën-treguesin e Kujdesit Shëndetësor Familjar, duke u vlerësuar me 1.70 pikë. Ky nën-tregues ofron njohuri mbi disponueshmërinë e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe funksionalitetin e tyre. Shumica e komunave kanë QKMF dhe Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) me objekte të mjaftueshme dhe pajisje teknike për të ofruar shërbime.

Pjesëmarrësit e FG-ve theksojnë se njëra prej pengesave më serioze në lidhje me QKMF-të dhe QMF-të lidhet me vonesat në zhvillimin dhe funksionalizimin e Sistemit të Informacionit Shëndetësor (SISH). Kjo përfshin dy çështje kryesore. Së pari, pa sistemin QKMF-të dhe QMF-të nuk mund ta regjistrojnë siç duhet historikun e pacientëve. Së dyti, rrjedha e informacionit ndërmjet institucioneve të kujdesit shëndetësor kërkon kohë dhe nganjëherë është e pamundur. Rezultatet e FG-ve gjithashtu tregojnë se disa QMF janë të mbingarkuara me pacientë, sepse nuk ka zonim komunal. Vlen të përmendet se disa komuna kanë një sistem të zonimit, megjithatë ai mezi funksionon për shkak të mungesës së ndërfunksionimit me regjistrin civil.

Pjesëmarrësit e FG-ve pajtohen se lista e barnave esenciale nuk menaxhohet siç duhet. Furnizimi me barna mjaft shpesh nuk korrespondon me kërkesat e QMF-ve. Në disa raste, dorëzohet vetëm gjysma e sasisë së kërkuar të barnave. Komunitat janë të detyruara të kërkojnë zgjidhje alternative për ta anashkaluar këtë çështje, siç është nënshkrimi i kontratave kornizë me barnatoret lokale.

Komunitat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës "relativisht të dobët" në nën-treguesin e Personelit Shëndetësor duke u vlerësuar me 1.44 pikë. Vetëm një e katërta e të anketuarve deklarojnë se ekziston një numër i mjaftueshëm i personelit shëndetësor në proporcion me numrin e popullsisë. Sipas pjesëmarrësve të FG-ve, niveli i lartë i qarkullimit të personelit është një problem tjetër. Përbërja e personelit të QKMF-ve dhe QMF-ve dominohet nga mjekët e përgjithshëm, të cilët pas disa viteve të shërbimit kanë tendencë të largohen. Edhe pse duket se janë vënë politikat nxitëse për personelin shëndetësor, shumica e të anketuarve pohojnë se ato nuk janë gjithmonë efektive.

TABELA 11: Shëndeti dhe mirëqenia sociale


	Drejtorë/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
QKMF-të dhe QMF-të				
Në komunën time ekziston një qendër kryesore e mjekësisë familjare dhe ka objekte moderne dhe pajisje teknike për të ofruar shërbime me cilësi të lartë.	34,5%	31,3%	15,9%	27,2%
Në komunën time ekzistojnë Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe ofrojnë shërbime shëndetësore të cilësisë së lartë.	23,6%	21,9%	13,7%	19,7%
Shërbimet sociale dhe familjare				
Komuna ofron shërbime sociale dhe familjare të shumfishta dhe të nivelit të lartë.	21,8%	25,0%	13,7%	20,2%
Ekziston një nivel i lartë bashkëpunimi dhe mekanizmi i bashkëpunimit funksional me OJQ-të në terren.	30,9%	43,8%	15,5%	30,1%
Komuna gjithmonë ofron shërbime sociale shtesë, bazuar në nevojat që shfaqen	12,7%	18,8%	9,2%	13,6%
Komuna e ka përfaqësuesin e vet në bordin e Institutit të Politikave Sociale.	32,7%	28,1%	41,3%	34,1%
Aktiviteti i shëndetësisë private				
Komuna ka njohuri të plotë dhe ka një regjistër të plotë të institucioneve shëndetësore private.	56,4%	43,8%	39,1%	46,4%

Komuna gjithmonë jep miratim paraprak të institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor.	60,0%	43,8%	27,7%	43,8%
Komuna ka një komision inspektimi të institucioneve private të kujdesit shëndetësor, i cili është gjithmonë aktiv.	36,4%	21,9%	15,9%	24,7%
Komuna ka mekanizma që sigurojnë bashkëpunimin me ministrinë e linjës.	76,4%	59,4%	60,9%	65,5%
Personeli shëndetësor				
Ka numër adekuat të personelit shëndetësor dhe stafi mjekësor është në proporcion me numrin e popullsisë dhe në nivel të lartë profesional.	29,1%	34,4%	22,9%	28,8%
Komuna ka politika stimuluese për personelin e vet shëndetësor dhe specializimin e tyre, dhe i zbaton ato me sukses.	30,9%	18,8%	7,4%	19,0%

3.10. Kultura, rinia, dhe sportet

Treguesi i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (KRS) është i përbërë nga tre nën-tregues siç janë paraqitur në Figurën 10. Komunitat janë vlerësuar me 1.59 pikë, gjë që e vendos performancën e tyre në nivelin e ulët të shkallës “mesatare”.

FIGURA 10: Treguesi i KRS-së dhe nën-treguesit e tij



Komunitat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës ‘mesatare’ në nën-treguesin e Planeve të KRS-së duke u vlerësuar me 1.95 pikë. Shumica dërrmuese e të anketuarve deklarojnë se komuna e tyre ka një plan vjetor për KRS, që është një kërkesë ligjore. Më shumë se dy të tretat e të anketuarve konsiderojnë se komuna e tyre ka kapacitete të kufizuara deri në të moderuara për hartimin e planeve të tilla. Opinione për cilësinë e planeve janë të ndara, ku një nivel pak më i lartë i të anketuarve e vlerësojnë cilësinë si të moderuar deri në të mirë. Pjesëmarrësit e FG-ve deklarojnë se OSHC-të janë mjaft aktive në asistimin e komunave për hartimin e planeve të KRS-së.

Komunitat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës “mesatare” në nën-treguesit e Qendrave dhe Eventeve të KRS-së duke u vlerësuar me 1.71 pikë. Në përgjithësi, të anketuarit i kanë ndarë pikëpamjet mbi dis-

ponueshmërinë e qendrave të KRS-së dhe mbulimin e tyre; gjysma e tyre konsiderojnë se komuna e tyre ka qendra të KRS-së me mbulim të madh, ndërsa gjysma tjetër pretendojnë të kundërtën. Tre të katërtat e të anketuarve të anketës e perceptojnë mirëmbajtjen e qendrave ekzistuese të KRS-së si të kënaqshme. Ekziston një perceptim i përgjithshëm se ka evente të rregullta kulturore dhe rinore, por niveli i pjesëmarrjes është mesatar.

Mungesa e përkrahjes financiare për aktivitetet e KRS-së duket se është një çështje kritike në Kosovë. Komunitat qendrojnë në nivelin e ulët të shkallës “relativisht të dobët” në nën-treguesin e Përkrahjes Financiare duke u vlerësuar me 1.15 pikë. Shumica dërrmuese e të anketuarve konsiderojnë se mbështetja për aktivitetet e KRS-së është relativisht e dobët. Pjesëmarrësit e FG-ve deklaruan se aktivitetet rinore nuk merren parasysh nga komunat si të rëndësishme. Ka raste kur një pjesë e buxhetit të alokuar për aktivitetet rinore rialokohet në kulturë. Pjesëmarrësit e FG-ve theksojnë më tej se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) nuk është shumë bashkëpunuese me drejtoritë përkatëse në nivel lokal. Në të vërtetë, përfaqësuesit e komunave duket se janë lënë pas dore në hartimin e dokumenteve strategjike, pavarësisht faktit se ata ndikohen drejtpërsëdrejti nga dokumentet e tilla.


TABELA 12: *Kultura, Rinia dhe Sporte*

	Drejtorë/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
Planet vjetore dhe politikat e KRS-së				
Komuna ka plane vjetore të nivelit të lartë në lidhje me kulturën, rininë dhe sportet, dhe ato rregullisht përditësohen .	64,0%	47,1%	20,3%	43,8%
Niveli i kapaciteteve për formulimin/hartimin e planeve kulturore dhe rinore është adekuate	44,0%	35,3%	12,5%	30,6%
Qendrat e KRS-së (përfshirë teatrot, klubet sportive, kinematë, bibliotekat, stadiumet, klubet etj.)				
Në komunë ka qendra të KRS-së dhe ato e mbulojnë të gjithë zonën komunale.	52,0%	50,0%	43,5%	48,5%
Niveli i mirëmbajtjes së tyre është i shkëlqyeshëm.	18,4%	12,1%	9,1%	13,2%
Aktivitetet e KRS-së janë të shpeshta dhe me pjesëmarrje të lartë.	32,0%	26,5%	15,1%	24,5%
Përkrahja financiare për aktivitetet e KRS-së				
Përkrahja financiare për aktivitetet e KRS-së është e lartë.	24,0%	17,6%	10,7%	17,4%
Aktivitetet kulturore mbështeten shumë nga donatorët.	14,0%	8,8%	7,7%	10,2%

3.11. Zhvillimi ekonomik dhe turizmi

Treguesi i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit përbëhet nga dy nën-tregues siç janë paraqitur në Figurën 11. Komunitat janë vlerësuar me 1.59 pikë, gjë që e vendos performancën e tyre në nivelin e ulët të shkallës ‘mesatare’.

FIGURA 11: Treguesi i zhvillimit ekonomik dhe turizmit dhe nën-treguesit e tij



Komunitat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës ‘mesatare’ në nën-treguesin e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik duke u vlerësuar me 1.73 pikë. Shumica dërrmuese e të anketuarve pohojnë se komuna e tyre e ka si planin zhvillimor komunal (PZhK) ashtu edhe planin zhvillimor ekonomik. Pjesëmarrësit e FG-ve pretendojnë se, në disa raste, plani zhvillimor ekonomik është një pjesë integrale e PZhK-së. Sa i përket zbatimit të planit zhvillimor ekonomik, pjesëmarrësit e FG-ve deklarojnë se komunitat në përgjithësi nuk i arrijnë objektivat e përcaktuara në planet e tyre përkatëse. Kjo është kryesisht për shkak se nuk ka lidhje në mes të këtij dokumenti strategjik dhe buxhetit komunal. Dy të tretat e të anketuarve pohojnë se kapacitetet e komunave për hartimin e planeve të zhvillimit ekonomik janë në përgjithësi mesatare.

Shumica dërrmuese e të anketuarve deklarojnë se komuna e tyre ka ndërmarrë iniciativë për krijimin e zonave ekonomike, dhe një e pesta e të anketuarve deklarojnë se zonat ekonomike janë pjesë e planit të zhvillimit ekonomik. Megjithatë, disa komuna duket se nuk kanë sipërfaqe të përshtatshme për të krijuar një zonë ekonomike ose nuk kanë kapacitete njerëzore për të zhvilluar një plan për zonat ekonomike. Sipas KIESA-s, Kosova ka zhvilluar pesë zona industriale, dy parqe biznesi dhe një park teknologjik.²² Këto lokacione janë të vendosura në vende strategjike dhe janë të lidhura shumë mirë me rrugët ekzistuese, edhe pse disa nuk janë funksionalizuar ende.

Komunitat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës “relativisht të dobët” në nën-treguesin e Turizmit duke u vlerësuar me 1.44 pikë. Duke qenë se jo të gjitha komunitat kanë parakushte natyrore për zhvillimin e turizmit, ky tregues duhet të interpretohet me kujdes. Rreth tre të katërtat e të anketuarve tregojnë se komuna e tyre nuk ka kapacitete për hartimin e planeve për zhvillimin e turizmit. Më shumë se gjysma e komunave nuk kanë qendra për informim dhe promovim të turizmit. Pjesëmarrësit e FG-ve theksojnë gjithashtu se komunitat me një numër të madh turistësh në përgjithësi kanë tendencë të kenë qendra turistike, megjithëse nuk janë funksionale gjatë gjithë kohës. Përveç kësaj, mirëmbajtja e atraksioneve turistike duket se ndodh në baza ad hoc. Pjesëmarrësit e FG-ve pajtohen se shumica e iniciativave të ndërmarra në këtë sektor janë përkrahur nga organizatat ndërkombëtare.

²² KIESA, <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=2,101> . (kliko në Zonat Ekonomike në krye të faqes së internetit)

TABELA 13: Zhvillimi ekonomik dhe turizmi

	Drejtorë/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal				
Komuna ka kapacitete për hartimin e strategjive për zhvillimin ekonomik lokal.	21,4%	33,3%	10,0%	21,6%
Ekziston një strategji për zhvillimin ekonomik lokal, e cila i përcakton urdhrat ekzekutiv dhe zbatohet në baza të rregullta.	28,6%	48,1%	26,6%	34,4%
Komuna tashmë ka funksionalizuar zonat ekonomike.	25,0%	29,6%	10,3%	21,7%
Strategjia për zhvillimin dhe promovimin e turizmit				
Komuna ka nivel të lartë të kapaciteteve për hartimin e planeve të zhvillimit të turizmit.	14,3%	22,2%	8,9%	15,1%
Ka një plan të strategjisë zhvillimore komunale dhe ai i përcakton vendimet ekzekutive dhe zbatohet në baza të rregullta.	32,1%	40,7%	18,8%	30,6%
Infrastruktura turistike/Turizmi kulturor				
Komuna ka një qendër për informim dhe promovim të turizmit.	17,9%	25,9%	12,9%	18,9%
Janë identifikuar lokacionet me interes turistik dhe kulturor.	96,4%	88,9%	78,6%	88,0%
Ka plane dhe burime financiare për mirëmbajtjen e rregullt të lokacioneve me interes turistik dhe kulturor.	29,6%	58,3%	29,1%	39,0%
Komuna ka investuar shumë në infrastrukturën fizike të turizmit.	10,7%	3,7%	6,3%	6,9%

3.12. Integrimi Evropian

Treguesi i Integritit Evropian, i cili e përshkruan situatën e përgjithshme në këtë sektor, qëndron në nivelin e lartë të shkallës “relativisht të dobët” duke u vlerësuar me 1.39 pikë. Duke pasur parasysh se të gjitha variablat e treguesit të Integritit Evropian janë disi të ngjashme, nuk ka nevojë për zberthim të mëtejme të treguesit.

Më shumë se dy të tretat e të anketuarve deklarojnë se komuna e tyre ka zyrtarë përgjegjës për Integrimin Evropian, ku pothuajse gjysma besojnë se numri i tyre është i mjaftueshëm. Shumica e të anketuarve deklarojnë se zyrtarët e Integritit Evropian flasin një gjuhë të huaj, ndërsa rreth gjysma e tyre mendojnë se trajnimi për zyrtarët e sapoemëruar është adekuat. Shumica e të anketuarve deklarojnë se shkëmbimi i përvojave me vendet anëtare të BE-së është shumë i kufizuar ose nuk ekziston.

Një e treta e të anketuarve pajtohen se procesi i koordinimit për zhvillimin e kornizës rregullative dhe përcaktimin e prioriteteve komunale për Integrimin Evropian është realizuar plotësisht. Rreth dy të tretat e të anketuarve besojnë se koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të MAPL-së dhe Ministrisë së Integritit Evropian (MIE) mund dukshëm të përmirësohet. Situata është disi më e mirë kur bëhet fjalë për ofrimin e

përkrahjes dhe këshillimit ligjor për komunën dhe Komisionet e Kuvendit Komunal me qëllim të pasqyrimin të Acquis dhe politikave relevante të BE-së. Rreth gjysma e të anketuarve besojnë se në përkrahja në këtë nivel jepet rregullisht dhe profesionalisht.

TABELA 14: Integrimi Evropian

	Drejtorë/ Shefa të Sektorëve	Nëpunës civilë komunalë	Anëtarë të Kuvendit	Mesatare
Zyrtarët për koordinimin e procesit të Integritimit Evropian në nivel komunal janë të nivelit më të lartë.	25,0%	7,1%	5,9%	12,7%
Koordinimi i procesit për zhvillimin e kornizës rregullative dhe vendosja e prioriteteve komunale drejt Integritimit Evropian është duke u realizuar plotësisht.	50,0%	28,6%	8,5%	29,0%
Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i zbatimit të rregullt të dokumenteve strategjike dhe prioriteteve komunale është duke u realizuar plotësisht nga zyrtarët.	50,0%	14,3%	8,9%	24,4%
Koordinimi në mes të organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve, shoqërisë civile dhe publikut është në nivelin më të lartë.	0,0%	7,1%	13,3%	6,8%
Koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të ZKIE (Zyra Komonale për Integritim Evropian), MAPL dhe MIE për paraqitjen e sfidave, nevojave dhe prioriteteve, si dhe për raportimin e rezultateve të arritura nga komuna, është në nivelin më të lartë.	50,0%	35,7%	10,7%	32,1%
Ofrimi i përkrahjes dhe këshillimit e shërbimeve ligjore për komunën dhe Komisionet e Kuvendit Komunal me qëllim të pasqyrimin të Acquis dhe politikave përkatëse të BE-së në zhvillimin e kornizës rregullative të komunës, bëhet në mënyrë profesionale.	50,0%	7,1%	9,6%	22,2%
Ka koordinim dhe bashkëpunim të plotë dhe të vazhdueshëm në komunë në mes të Zyrës së Personelit dhe Zyrës për Komunikim dhe Informim Publik. Ky koordinim dhe bashkëpunim është në nivelin më të lartë. Takimet mbahen në bazë të agjendës dhe sipas nevojës.	25,0%	28,6%	14,4%	22,7%
Të gjithë zyrtarët komunalë të ZKIE-s njohin gjuhë të huaja.	0,0%	0,0%	6,6%	2,2%
Zyrtarët e rinj janë trajnuar plotësisht në fushën e Integritimit Evropian.	50,0%	14,3%	7,4%	23,9%
Shkëmbimi i përvojave me vendet që janë anëtarësuar në BE është në nivel të lartë.	0,0%	7,1%	7,7%	5,0%

4. PERFUNDIMET DHE REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

Pas vlerësimit të kapaciteteve të vitit 2009, që ishte përpjekja e parë e MAPL-së për identifikimin e kapaciteteve ekzistuese dhe boshllëqeve në nivel komunal, UNDP-ja dhe MAPL realizuan të njëjtën anketë për t'i kuptuar nivelet aktuale të kapaciteteve dhe për t'i identifikuar fushat që kërkojnë vëmendje.

Ky raport i ka shqyrtuar kapacitetet komunale në 12 fusha në lidhje me pikat e forta dhe dobësitë në zbatimin e kompetencave vetanake dhe të deleguara. Rekomandimet ofrojnë një pikënisje për komunitat, MAPL-në dhe palët e tjera të interesit për t'i zhvilluar ndërhyrjet të cilat kontribuojnë në arritjen e rezultateve të dëshiruara të zhvillimit.

Komunitat kanë nivele të ndryshme të kapaciteteve, gjë që kërkon një përkrahje pothuajse të përshtatur, dhe - në disa raste - një vlerësim më të thellë për identifikimin e shkaqeve rrënjësore për nivelet më të ulëta të kapaciteteve. Sigurimi i rekomandimeve specifike mund të kthehet në pengesë për shkak të rrezikut të pandarë të zhvillimit të një qasjeje "të unifikuar" për sektorët me nevoja të ndryshme, prandaj rekomandimet duhet të përdoren si udhëzime të përgjithshme.

Gjetjet e këtij vetë-vlerësimi duhet të shihen në lidhje me Raportin e Performancës Komunale²³ të MAPL-së dhe Raportin Mozaik 2015. Megjithëse mbulojnë korniza të ndryshme kohore, triangulimi i të dhënave dhe informacionit duhet të çojë drejt një pasqyre më të qartë të mënyrës se si perceptohen çështjet dhe, si rezultat, drejt zhvillimit të ndërhyrjeve pragmatike dhe përkrahjes.

Administrata dhe personeli

Komunitat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës "relativisht të mirë", në treguesin e Administratës dhe Personelit, duke u vlerësuar me 2.10 pikë, gjë që sugjeron një nivel të pranueshëm të kapaciteteve.

Komunitat tregojnë një mungesë të mekanizmave të vendosur për ta marrë dhe menaxhuar pasurinë e njohurive ekzistuese, duke përfshirë edhe kujtesën institucionale. Një pjesë e problemit qëndron në mungesën e planifikimit të vazhdimësisë që e mundëson kalimin në mes të nëpunësve civilë të rinj dhe atyre që largohen. Kjo rezulton me njohuritë e tretura ose të harruara institucionale të bazuara në njerëz, vendimtare për efektivitetin e komunës.

Derisa nëpunësit civilë komunalë duket se kanë përvojë solide pune, kualifikime dhe përkushtim ndaj përgjegjësisë të tyre, ekziston një nivel i ndikimit të panevojshëm në procesin e vendimmarrjes që kërcënon pavarësinë e tyre. Ekzistenca e një shkalle të ndërhyrjeve politike në vendimmarrjen e përditshme është e evidente, gjë që e pengon ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tyre.

• **Rekomandim:** Komunitat duhet të vendosin udhëzime dhe procedura standarde të veprimit për marrjen e njohurive të gjeneruara në kuadër të institucioneve të tyre. Këto udhëzime dhe procedura duhet

²³ Raporti i Performancës Komunale i MAPL-së publikohet çdo vit, kështu që ciklet e Raportit të Vetë-Vlerësimit dhe Mozaikut nuk përputhen.

të ndihmojnë në organizimin e informacionit në mënyrë të qartë, koncize dhe të disponueshme për autoritetet komunale. Ky proces duhet gjithashtu t'i identifikojë 'njohuritë thelbësore institucionale', gjë që nënkupton proceset, rregullat dhe procedurat operative që duhet t'i njohë dhe t'i ndjekë secili anëtar i personelit komunal.

- **Rekomandim:** Komunitat duhet të aplikojnë procedura rigoroze të rekrutimit dhe përzgjedhjes, zhvillim të vazhdueshëm profesional, vlerësim të rregullt dhe domethënës të performancës, sistematizim të përshkrimeve të pozitive dhe vendeve të punës, që është domosdoshme nëse kërkohet të rriten kapacitetet në nivel komunal.

- **Rekomandim:** Procesi në vazhdimësi i modernizimit të administratës publike ka pasur efekt të kufizuar në nivel komunal. Kjo pritet të ndryshojë në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, meqë Plani i Veprimit 2018-2020 parasheh një varg aktivitete që do t'i ndikojnë komunitat. Rekomandohet që MAPL në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike (MPA) duhet të organizojnë seanca informative për komunitat në lidhje me zhvillimet e ardhshme dhe ndikimet e tyre të mundshme.

Buxheti dhe Financat

Komunitat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës "relativisht të mirë" në treguesin e Buxhetit dhe Financave ku janë vlerësuar me 2.07 pikë.

Teksa komunitat duket se kanë kapacitete të mjaftueshme për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe për t'iu përgjigjur qarkoreve të buxhetit e planifikimit dhe alokimit të buxhetit, tavanet e vendosura nga MF-ja duket se pengojnë efektivitetin e komunave për t'i adresuar nevojat e tyre. Kjo gjetje u theksua edhe nga diskutimet e FG-ve në vetë-vlerësimin e vitit 2009. Si i tillë, kërkon një analizë të thelluar për shkakun rrënjësor.

- **Rekomandim:** Forcimi i koordinimit dhe dialogut politik ndërmjet MF-së dhe komunave për alokimin e planifikimit të buxhetit dhe qarkoret buxhetore, për të siguruar menaxhim më të mirë të financave publike.

Një çështje shqetësuese, siç është theksuar edhe në raportin e vitit 2009, është kapaciteti i komunave për të gjeneruar të Hyra Vetanake (HV). Dy pengesat kryesore janë: i) mungesa e zbatimit të rregulloreve në lidhje me mbledhjen e të hyrave vetanake dhe ii) aftësia e komunave për të planifikuar dhe buxhetuar realisht për të hyrat vetanake. Ekziston nevoja për një planifikim të fuqishëm dhe të bazuar në dëshmi mbi gjenerimin e të hyrave vetanake, si dhe për forcimin e pajtueshmërisë dhe zbatimit. Komunitat kanë të dhëna historike të cilat mund të përdoren në procesin e vlerësimit, planifikimit dhe mbledhjes së të hyrave vetanake

- **Rekomandim:** Komunitat duhet të miratojnë planifikimin e buxhetit të bazuar në dëshmi për të hyrat vetanake, duke u bazuar në të dhënat historike. Analiza e tyre, duke përfshirë përshtatjet për ndryshimet në mjedisin ekonomik, do të sigurojë një bazë të fuqishme për planifikim real, duke mbështetur një cikël më të shëndetshëm financiar. Kërkohej shqyrtim i mëtejshëm i afatit kohor të transferimit të burimeve indirekte të të ardhurave dhe i funksionimit të sistemit të informacionit të menaxhimit për të hyrat vetanake; ky i fundit do të përmirësojë raportimin, gjurmimin dhe gjenerimin e të hyrave vetanake.

- **Rekomandim:** Udhëheqësia komunale, së bashku me MF dhe MAPL, duhet të identifikojnë shkaqet rrënjësore, dhe të zhvillojnë zgjidhje për ta kapërcyer mungesën e zbatimit të rregulloreve mbi mbledhjen e të hyrave vetanake.

Bujqësi

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare' në treguesin e Bujqësisë, ku janë vlerësuar me 1,97 pikë.

Mungesa e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet drejtorive përkatëse në nivel komunal duket se ka një efekt negativ në performancën e sektorit bujqësor. Një nga arsyet kryesore për bashkëpunimin e ulët është për shkak të asimetrisë në shkëmbimin e informacionit ndërmjet zyrtarëve të MBPZHR-së dhe komunave. Një faktor tjetër që ndikon në bashkëpunim është qasja e centralizuar e partnerëve dhe donatorëve për ofrimin e asistencës dhe shërbimeve bujqësore gjatë kanalizimit të përkrahjes përmes MBPZHR-së. Mungesa e përfshirjes së komunës, ose të paktën e shqyrtimit të nevojave në nivel komunal, ngrit çështje rreth qëndrueshmërisë. Aspekti i bashkëpunimit dhe koordinimit duhet të trajtohet siç duhet si nga zyrtarët komunalë ashtu edhe nga institucionet qendrore për ta përmirësuar joefikasitetin e shkaktuar nga shkëmbimi i dobët i informacionit. Mungesa kronike e personelit në drejtoritë bujqësore, u ngrit si një çështje serioze nga pjesëmarrësit e FG-ve gjë që ndikon në cilësinë, efektivitetin dhe efikasitetin e shërbimeve.

- **Rekomandim:** Zhvillimi i një sistemi të qartë dhe transparent të shkëmbimit të informacionit ndërmjet MBPZHR-së dhe komunave, për ta zvogëluar natyrën ekzistuese asimetrike të komunikimit të tyre. Kjo do të çojë në përmirësimin e komunikimit dhe do të kontribuojë në një koordinim më të mirë ndërmjet MBPZHR-së dhe komunave në zbatimin e planeve, projekteve dhe subvencioneve për zhvillimin e bujqësisë. E njëjta gjë vlen edhe për bashkëpunimin dhe komunikimin në mes të drejtorive komunale.

- **Rekomandim:** Duke përdorur një qasje nga poshtë-lart, MBPZHR-ja dhe donatorët duhet ta kërkojnë kontributin komunal gjatë zhvillimit të projekteve të përkrahjes bujqësore. Kjo do t'u mundësojë komunave që ta planifikojnë përkrahjen pas projektit për përfituesit, duke e siguruar qëndrueshmërinë e investimeve fillestare.

- **Rekomandim:** Personeli i pamjaftueshëm i drejtorive të bujqësisë duhet të adresohet në një nivel të politikës, pasi që çdo rritje e numrit të personelit ka pasoja financiare afatgjata. Si pikë fillestare duhet të përdoret modernizimi i administratës publike dhe ndryshimet e ardhshme në kornizën ligjore që rregullojnë administratën publike dhe shërbimin civil.

Kurse përdoruesit e tokës shpesh nuk kërkojnë leje për ta ndryshuar shënimin e tokës, ndërsa komunat zakonisht nuk kanë burime të mjaftueshme njerëzore për t'i inspektuar këto shkelje. Kjo është në kundërshtim me planet komunale të mbrojtjes së tokës që duket të jenë të përcaktuara mirë. Ashtu si në sektorët tjerë, janë të dukshme dhe duhet të adresohen lidhjet shkakore në mes të burimeve njerëzore në dispozicion, komunikimit, zbatimit të rregullave dhe rregulloreve, si dhe respektimit të kornizës ligjore.

- **Rekomandim:** Duhet të krijohet një kornizë e fuqishme për inspektimin e shkeljeve të rregullave dhe rregulloreve për shënimin e tokës, të lidhura me burimet njerëzore dhe shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë masa ndëshkuese. Siç është theksuar në seksionin e Infrastrukturës Fizike, në dispozicion të personelit komunal duhet të vihen mjetet adekuate për t'i përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Urbanizmi

Komunat janë pozicionuar në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare' në treguesin e Urbanizmit, me një vlerësim prej 1,95 pikë.

PZHK, HZK dhe PDRR kërkojnë njohuri të specializuara të cilat nuk duken lehtësisht të disponueshme në komuna. Praktika e kontraktimit të zhvillimit të këtyre planeve ofron një zgjidhje të përkohshme, pasi që asnjëra nga këto ndërhyrje nuk e përfshin zhvillimin e kapaciteteve për personelin komunal. Po ashtu duhet të theksohet se teksta komunat duket se kanë një sistem për menaxhimin e pronës publike, efektiviteti i tij është i diskutueshëm, siç është edhe vërtetësia e inventarit komunal të pronave. Gjetje të ngjashme janë raportuar edhe në vlerësimin e vitit 2009, duke treguar se ka pasur pak përmirësime.

• **Rekomandim:** Komunat duhet ta hulumtojnë bashkëpunimin ndër-komunal, veçanërisht me komunat që kanë planifikim dhe zbatim të avancuar, për të përfituar nga përvojat dhe ekspertiza e tyre. Bashkëpunimi ndër-kufitar dhe binjakëzimi gjithashtu mund ta mbështesin procesin e planifikimit. Në proces duhet gjithashtu të integrohet edhe një komponent i zhvillimit të kapaciteteve, pasi që kapaciteti i kufizuar i personelit ekzistues është vërejtur si problem.

Mospërputhja në mes të PZHK-së, si një dokument shumë-sektorial, dhe planifikimit të buxhetit është gjithashtu një tjetër pengesë, pasi ndikon në qëllimet afatgjata në lidhje me zhvillimin hapësinor, social dhe ekonomik. Përkundër rëndësisë që i është bashkangjitur PZHK-së dhe kërkesës ligjore që të gjitha komunat ta jenë të pajisura me të, është e qartë se jo të gjitha komunat janë në pajtim me këtë kërkesë.

• **Rekomandim:** Bashkëpunimi me ministritë e linjës, siç janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ose Ministria e Financave, në fazën nismëtare të PZHK-së, për t'i adresuar si nevojat komunale, ashtu edhe kornizën rregullative dhe kufizimet financiare.

Nën-treguesi i Rregulloreve të urbanizmit analizon shkallën e zbatimit të standardeve që rregullojnë kontrollin e ndërtimit dhe tregon se zbatimi i këtyre dokumenteve rregullative shihet si pjesërisht i rëndësishëm. Për më tepër, as Ligji mbi Planifikimin Hapësinor nuk zbatohet siç duhet. Ligji kërkon që një inspektor komunal të kontrollojë çdo ndërtim në ngritje e sipër për pajtueshmërinë me planet dhe standardet e miratuara të efikasitetit, gjë që nuk ndodh rregullisht. Kapaciteti i kufizuar për auditimin dhe monitorimin e ndërtimeve krijon hapësirë për investitorët që të devijojnë nga planet e miratuara, duke ndikuar negativisht në mjedis dhe ofruesit e shërbimeve publike, siç janë ujësjellësi, kanalizimet dhe mbeturinat.

• **Rekomandim:** Forcimi i sistemit të pajtueshmërisë, nëpërmjet përmirësimit të të kuptuarit të politikave dhe rregulloreve përkatëse për ndërtim. Të theksohet nevoja për zbatimin e tyre në kohë, si dhe mënyra si ndikon sistemi i pajtueshmërisë në buxhetin komunal dhe zhvillimin ekonomik.

Të drejtat e njeriut

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare' në treguesin e të Drejtave të Njeriut, duke u vlerësuar me 1.92 pikë.

Zyrat komunale për Komunitete dhe Kthim duket se kanë detyra dhe përgjegjësi të qarta. Megjithatë, ato ose nuk janë funksionale ose janë pjesërisht funksionale. Një aspekt pozitiv është ekzistenca e mekanizmave të qartë për vendimmarrje për çështjet e pakicave, gjë që u konfirmua nga shumica e të anketuarve. Komunikimi efektiv dhe përkthimi profesional i dokumenteve në të gjitha gjuhët zyrtare është parakusht për një trajtim të barabartë të komuniteteve. Megjithatë, përkthimi i dokumenteve dhe cilësia e tyre duket se janë çështje për të gjitha komunat, gjë që është më e theksuar në komunat me shumicë serbe.

Rekomandim: Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (2006) siguron përdorimin e barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare.²⁴ Duhet të adresohen burimet e pamjaftueshme njerëzore dhe financiare, të cilat e pengojnë qasshmërinë e komuniteteve në proceset vendimmarrëse. Në bashkëpunim me MAPL-në, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK), si dhe Zyrën për Çështje të Komuniteteve (ZÇK/ZKK), të gjitha komunat duhet t'i rrisin kapacitetet e tyre për të siguruar përkthime të rregullta, cilësore dhe në kohën e duhur.

Prokurimi komunal

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare' në treguesin e Prokurimit Komunal, duke u vlerësuar me 1.91 pikë.

Teksa komunat duket se kanë mekanizëm funksional për identifikimin dhe përzgjedhjen e projekteve dhe procesi është relativisht i paanshëm, nëpunësit civilë kanë shkathtësi dhe përvojë të moderuar për zhvillimin e projekteve. Kjo çon në shkelje procedurale, pavarësisht faktit se zyrtarët e prokurimit duhet të jenë të çertifikuar. Bashkë me referencat e pamjaftueshme të neneve përkatëse të ligjit të prokurimit dhe dokumenteve të tjera ligjore, këto dykuptimësi/paqartësi të krijuara krijojnë hapësirë për operatorët ekonomik që të parashtrajnë ankesa. Procedurat e mëvonshme ligjore krijojnë kosto shtesë dhe komunave u marrin shumë kohë.

• **Rekomandim:** Doracakët periodikë të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), të cilat ofrojnë rregulla dhe udhëzime operacionale për zyrtarët e prokurimit, duhet të përdoren si referencë dhe burim i praktikave të vendosura. Edhe sistemi i prokurimit elektronik duhet ta përmirësojë efikasitetin dhe transparencën e procesit.

• **Rekomandim:** Teksa ekzistojnë një varg mekanizmesh dhe institucionesh për ta mbështetur një proces efektiv dhe efikas të prokurimit, ato nuk shfrytëzohen prej komunave. Kërkohej një analizë për t'i kuptuar shkaktarët e shkeljeve procedurale dhe çështjet tjera të lidhura me prokurimin, ku Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) dhe KRPP-ja duhet ta udhëheqin procesin.

Menaxhimi i kontratave, si pjesë e procesit, është gjithashtu një shqetësim. Menaxherët e kontratave i trajtojnë raportet e progresit si një formalitet, pasi që ato nuk e pasqyrojnë progresin në mënyrë të saktë. Kjo shpie në një cilësi më të ulët të punimeve dhe rritje të mosrespektimit të specifikave të listuara në tender. Në kuadër të treguesit të Etikës së Prokurimit është gjetur një lidhje shkakore, ku kapacitetet për zbatimin efektiv të parimeve etike dhe kodeve të sjelljes së ekipeve të prokurimit, si dhe niveli i koordinimit me autoritetet qendrore janë vetëm në nivel të moderuar. Niveli i kufizuar i bashkëpunimit vërehet edhe në mes të komunave, gjë që do të mund ta mbështeste përmirësimin e ekonomive të shkallës dhe përdorimin efikas të buxheteve në dispozicion.

• **Rekomandim:** Për të shmangur mangësitë në pajtueshmërinë e menaxhimit të kontratave duhet të zhvillohen aktivitetet formale të zhvillimit të kapaciteteve (p.sh. trajnimi, testimi dhe ndërtimi i njohurive). Kjo duhet të ndodhë, në mënyrë ideale, si pjesë integrale e procesit të çertifikimit për zyrtarët e prokurimit.

²⁴ http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2006_02-L37_en.pdf

Arsim

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës 'mesatare' në treguesin e Arsimit, me një rezultat prej 1.77 pikë.

Për Rregulloren e Shkollave çështja kryesore është zbatimi i tre rregulloreve/kodeve në vijim: i) Rregullat e Procedurës për Institucionet Para-shkollore dhe ato të Arsimit Fillor dhe të Mesëm; ii) Kodi i Sjelljes iii) Protokollin e Rregullores për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar²⁵. Shumica e komunave duket se i kanë hartuar dhe miratuar dy rregulloret e para, megjithatë monitorimi i zbatimit të tyre ose nuk ndodh ose zhvillohet në mënyrë të parregullt. Nga ana tjetër, mungojnë njohuritë dhe zbatimi i rregullores për parandalimin e dhunës.

• **Rekomandim:** Nga këndvështrimet e koordinimit dhe bashkëpunimit, MASHT-i duhet të angazhohet në mënyrë proaktive me Drejtoritë Komunale të Arsimit për t'i informuar ato për ndryshimet në kornizën e politikave, për t'u konsultuar për sfidat e mundshme dhe për të mbledhur informata kthyesë për çështje të tjera shqetësuese. Kjo do të çojë në përmirësimin e të kuptuarit, angazhimit, monitorimit dhe zbatimit të rregulloreve.

Nën-treguesi për Arsimin Fillor dhe të Mesëm vë në dukje se shkollat fillore dhe të mesme nuk kanë lokale të përshtatshme të tilla si laboratorët për kimi, fizikë, biologji dhe lëndë të tjera shkencore. Kryesisht, të gjitha investimet në këtë drejtim ishin rezultat i përkrahjes së donatorëve. Ndërkohë, mangësitë në shërbimet shëndetësore dhe pedagogjike perceptohen si çështje serioze në shkollat fillore dhe të mesme. Nuk ka kontrolle të rregullta nga një mjek i përgjithshëm dhe shërbimet pedagogjike janë shfuqizuar.

• **Rekomandim:** MASHT dhe Ministria e Shëndetësisë duhet të angazhohen me komuna për t'i adresuar si çështjet politike ashtu edhe ato financiare që lidhen me sigurimin e mjediseve të përshtatshme të mësimnxënies dhe përmirësimin e infrastrukturës arsimore.

Rekrutimi i mësimdhënësve të rinj dhe ri-caktimi²⁶ i atyre ekzistues, pas heqjes së klasës së 13-të në vitin 2014, karakterizohet nga disa parregullsi. Numri dhe përbërja e komisioneve të rekrutimit ndryshon nga një komunë në tjetrën, duke e bërë procesin e rekrutimit jo uniform dhe të cenueshëm ndaj pretendimeve për padrejtësi dhe madje keqmenaxhim. Edhe ri-caktimi i mësimdhënësve²⁷ në pozita me orar të plotë paraqet po ashtu problem, pasi që në vend që të vlerësohet mundësia e ri-caktimit, shkollate e mesme i shpallin vendet e reja të punës, të cilat krijojnë pakënaqësi dhe kosto të mëtejme financiare.

• **Rekomandim:** Komunat në bashkëpunim me MASHT duhet të identifikojnë një drejtim veprimi që trajton çështjen e ri-caktimit të mësimdhënësve në mënyrë uniforme, që përcillet me procedura standarde operative që adresojnë çështjen e përbërjes së paneleve të rekrutimit, për ta adresuar perceptimin e keqmenaxhimit të mundshëm. Në nivelin e politikave MASHT duhet ta bëjë një analizë të hollësishme të numrit në rënie të nxënësve në zonat rurale, gjë që pothuajse është duke e ndikuar cilësinë e arsimit,

Shërbimet publike dhe ato të emergjencave

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës 'mesatare' në treguesin e Shërbimeve Publike dhe atyre të Emergjencave me një rezultat prej 1.72 pikë.

Niveli i kapaciteteve në nën-treguesin e furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe menaxhimit të mbeturinave

²⁵ Hartuar nga MASHT, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/rregullore-grk-nr-21-2013-per-protokollin-per-parandalimin-dhe-referim.pdf>

²⁶ Asnjë informacion nuk ishte i disponueshëm nëse MASHT ose komunat kishin një plan të qartë për mënyrën e menaxhimit të procesit ose ri-caktimit pas heqjes së klasës së 13-të.

²⁷ Mësuesit të cilët kanë dhënë mësim në klasën e 13-të.

u vlerësua me në një nivel të mesëm, që është një përmirësim nga vetë-vlerësimi i vitit 2009. Sidoqoftë, gjetjet e vitit 2017 tregojnë se ka ende vend për përmirësim.

Shqetësimi kryesor është mungesa e një politike të koordinuar të menaxhimit se si të ofrohen shërbime publike, si në nivelin komunal ashtu edhe në atë rajonal, sepse kjo krijon mundësi të shpërdoruara dhe e rrit koston financiare. Kjo është shoqëruar me paqartësinë në dallimin mes roleve dhe përgjegjësive përkatëse të ndërmarrjeve publike. Shqetësimi i mëtejshëm është edhe sjellja e kompanive të menaxhimit të mbeturinave pasi që disa prej tyre krijojnë deponi ilegale me efekte shkatërruese për mjedisin dhe ndikojnë negativisht në shëndetin e banorëve. Megjithatë ka pasur investime të konsiderueshme nga partnerët ndërkombëtarë në menaxhimin e mbeturinave, gjetjet tregojnë se ekziston një nevojë e përgjithshme për ta zbatuar një politikë të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe për të siguruar që të gjitha ndërmarrjet publike komunale dhe rajonale t'u përmbahen kërkesave të politikave.

• **Rekomandim:** Dykuptimësia në mes të roleve dhe përgjegjësive të ndërmarrjeve publike në nivel rajonal dhe komunal duhet të jetë pjesë e një analize specifike për të identifikuar nëse problemet dalin nga korniza ligjore dhe/ose interpretimi i saj, ose çështje të tjera organizative. Për më tepër, duhet të bëhet një analizë në kuadër të kontekstit më të gjerë të procesit të reformës së administratës publike, veçanërisht e organizimit dhe funksionimit të administratës publike dhe e përputhshmërisë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Ndërkohë, një proces i fuqizuar i menaxhimit dhe zbatimit të kontratave i mbështetur nga monitorimi dhe inspektimi efektiv duhet ta sigurojë pajtueshmërinë me politikën e përshkruara.

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të rezultatit 'mesatar' në treguesin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, duke u vlerësuar me 1.68 pikë.

Megjithatë komunat kanë numër adekuat të personelit shëndetësor profesional - në përpjesëtim me popullsinë e tyre - një nga problemet lidhet me shkallën e qarkullimit të personelit; shumica e personelit mjekësor në QKMF-ve dhe QMF-ve janë mjekë të përgjithshëm të cilët kanë tendencë të largohen pas disa viteve shërbimi. Një çështje me interes të madh për komunat është furnizimi, menaxhimi dhe shpërndarja e barnave esenciale. Për t'i përmbushur kërkesat e qytetarëve, komunat janë të detyruara të gjejnë zgjidhje alternative për furnizimin e barnave esenciale, nëpërmjet marrëveshjeve kornizë me barnatoret lokale. Kjo krijon probleme të reja të mundshme në aspektet e prokurimit, buxhetit në dispozicion dhe cilësisë së përgjithshme të barnave.

• **Rekomandim:** Derisa çështjet e sektorit të shëndetësisë janë komplekse dhe reforma po vazhdon, është i dukshëm një model i pamjaftueshmërisë kronike të barnave nga lista esenciale, jo vetëm nga raporti i vitit 2009, por edhe nga vlerësimet dhe shqyrtimet e tjera. MSH-ja duhet të vendosë kritere të qarta për mënyrën si përditësohet lista e barnave esenciale. Mund të vendoset një lidhje shkakore ndërmjet finalizimit të hartave të zonimit dhe furnizimit me barna, gjë që edhe mundëson bashkëpunim më të mirë për këtë çështje.

Sigurimi i ndihmës sociale gjithashtu identifikohet si një fushë që kërkon vëmendje veçanërisht nga niveli qendror, në bashkëpunim me komunat. FG-të shprehin shqetësime për mënyrën se si ka ndodhur decentralizimi i shërbimeve sociale, pasi që nuk është pasuar nga decentralizimi i financave; si i tillë, e pengon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për qytetarët. Për më tepër, një shqetësim në nivelin komunal është se sistemi mund të manipulohet, kështu që individët që nuk i plotësojnë kriteret për ndarjen e shërbimeve sociale ende janë në gjendje të kërkojnë përfitime.

- **Rekomandim:** Shpërndarja e dobët e shërbimeve sociale dhe shëndetësore për qytetarët nënkupton nevojën për një qeverisje të fuqishme, një sistem financiar të fuqishëm dhe procese transparente. Në nivelin e politikave, një ndryshim nga transferimi i përgjithshëm i grantit në një formulë financiare të caktuar të grantit për shërbimet sociale, do t'i adresonte nevojat e komunave.

- **Rekomandim:** Të kryhet një vlerësim i detajuar dhe i thellë i politikës dhe kornizës ligjore së bashku me një rishikim të procedurave standarde të operimit, kriterëve të përshatshmërisë, qasjes dhe shkëmbimit të informacionit, si dhe të monitorimit. Mungesa e ndërveprueshmërisë ndërmjet bazave të të dhënave në institucione të ndryshme (shërbimet sociale, zyra e punësimit, administrata tatimore, kadastra, regjistrimi i automjeteve etj.) lejon keqpërdorimin e sistemit. Lidhja e këtyre bazave të të dhënave nëpërmjet një platforme ndërveprimi do të krijojë një rrjet informacioni që mund ta përmirësojë procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes.

Kultura, rinia dhe sportet

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës 'mesatare' në treguesin e KRS-së, me një vlerë prej 1,59 pikë. Përkrahja e pamjaftueshme financiare dhe bashkëpunimi i kufizuar ndërmjet MKRS-së dhe drejtorive përkatëse në nivel lokal janë pengesa kryesore në sektorin e KRS-së.

Derisa shumica e komunave kanë plane të KRS-së, cilësia e tyre dhe niveli i përkrahjes financiare duket se janë problem, veçanërisht për aktivitetet e lidhura me të rinjtë. Një aspekt më pozitiv është se komunat raportojnë një bashkëpunim të mirë me OShC-të. Pak rëndësi u kushtohet aktiviteteve rinore, gjë e cila dëshmoherë pas here nga rialokimi i buxhetit për rininë në vijën buxhetore të kulturës. Gjithashtu, disponueshmëria e qendrave të KRS-së dhe mbulimi që ato ofrojnë është disi i kufizuar.

- **Rekomandim:** Komunat duhet ta marrin parasysh kulturën, rininë dhe sportet – KRS si një entitet të ndërvarur (të lidhur), dhe jo si linja të ndara buxhetore. Ato duhet të angazhohen me rininë për t'i hartuar aktivitetet të cilat janë tërheqëse për ta dhe të cilat çojnë drejt një shoqërie produktive.

Zhvillimi ekonomik dhe turizmi

Komunat qëndrojnë në nivelin e ulët të shkallës 'mesatare' në treguesin e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, vlerësuar me 1.59 pikë.

Nën-treguesi i Turizmit dhe nën-treguesi i Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik janë të ndërlidhur, pasi që sektori në rritje i turizmit ndikon në rritjen e ekonomisë lokale. Një sektor i turizmit në rritje çon në rritjen e punësimit në kuadër të komunës dhe në përmirësimin e infrastrukturës (siç janë rrugët dhe urat) për shkak të rritjes së të ardhurave nga turistët. Për më tepër, zhvillimi ekonomik, bazuar në një gamë të larmishme të aktiviteteve ekonomike, do të kontribuojë në përmirësimin e mundësive që komunat të rrisin të hyrat vetanake (HV).

- **Rekomandim:** Komunat duhet të hulumtojnë se si t'i tërheqin turistët duke u bazuar në propozimet me vlerë (turizmi rural, kulturor ose bujqësor, në mesin e të tjerave) në bashkëpunim me institucionet qendrore, organizatat ndërkombëtare dhe sektorin privat. Kjo duhet të kombinohet me rritjen e nivelit të arsimit publik, vetëdijes dhe trajnimit për turizmin dhe trashëgiminë kulturore (të prekshme dhe të paprekshme). Komunat duhet gjithashtu t'i forcojnë partneritetet me Ministrinë për Zhvillim Rajonal dhe Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturor për ta mundësuar rritjen e mëtejme në sektorin e turizmit.

Integrimi Evropian

Komunat qëndrojnë në nivelin e lartë të shkallës “relativisht të dobët” në treguesin e Integritimit Evropian, duke u vlerësuar me 1.39 pikë.




Teksa shumica e komunave raportojnë nivele disi të pranueshme të kapaciteteve njerëzore për Integritimin Evropian, në mënyrë sasiore dhe cilësore, procesi i koordinimit për zhvillimin e kornizës rregullative dhe përcaktimin e prioriteteve komunale duke përfshirë arritjet e tyre, paraqet sfida. Derisa trajnimet kanë pasur një efekt pozitiv në njohuritë e zyrtarëve të Integritimeve Evropiane, çështja kryesore mbetet arsimimi i tyre akademik i cili nuk është gjithmonë relevant për pozitën në të cilat ata janë caktuar.

Koordinimi, bashkëpunimi dhe komunikimi ndërmjet zyrtarëve komunalë për Integritime Evropiane, MA-PL-së dhe MIE-së është vërejtur si sfida, ashtu siç është edhe nevoja për zhvillim të vazhdueshëm profesional në këtë temë. Kjo ndikon edhe në aftësinë për ta monitoruar, vlerësuar dhe raportuar në mënyrë adekuate zbatimin e dokumenteve strategjike.

Nuk duhet të nënvlerësohet rëndësia e komunave në zbatimin e detyrimeve të MSA-së (Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit), andaj, duhet të sigurohet përkrahje adekuate nga ministritë e linjës, e cila do të jetë e përshtatur sipas nevojave të tyre.


- **Rekomandim:** Zbatimi i MSA-së është një nga prioritetet kryesore strategjike kombëtare që kërkon kapacitete adekuate njerëzore, si dhe ato financiare. Duhet të sigurohen kapacitete të mjaftueshme për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e zbatimit të dokumenteve strategjike.

SHTOJCAT²⁸




28 Vini re se të dhënat e ofruara në Shtojca duhet të interpretohen me kujdes, pasi që madhësia e mostrës garanton validitet statistikor vetëm për rezultatet e grumbulluara.


2a. Cilat janë shkaqet për këtë bashkëpunim të ulët/mosbashkëpunim? [Zgjedhje e shumëfishtë]




3. Cili është niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit me nivelin qendror (ministritë)




3a. Cilat janë shkaqet për këtë bashkëpunim të ulët /mosbashkëpunim? [Zgjedhje e shumëfishtë]




4. Cili është niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile?




4a. Cilat janë shkaqet për këtë nivel të ulët bashkëpunimi /mosbashkëpunim? [Zgjedhje e shumëfishtë]




5. Cili është niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit me anëtarët e komunitetit të biznesit brenda dhe jashtë komunës?




5a. Cilat janë shkaqet për këtë nivel të ulët bashkëpunimi /mosbashkëpunim? [Zgjedhje e shumëfishtë]




6. A ekziston një akt komunal që përcakton bashkëpunimin ndër-komunal?




7. Cili është niveli i bashkëpunimit ndër-komunal?




8. Cili është niveli i qasjes në dokumentet publike?




9. A jepet brenda afateve ligjore qasja në dokumentet e ofruara në përputhje me legjislacionin në fuqi?




10. Si do të vlerësonit nivelin e publikimit të dokumenteve komunale?




11. Si bëhet përkthimi i dokumenteve komunale?




12. Cili është niveli i infrastrukturës së teknologjisë informative (TI)?




13. Deri në çfarë mase përdoret teknologjia nga personeli komunal?




14. Deri në çfarë mase përdoren e-maillet zyrtare?




15. Si e vlerësoni mjedisin e punës brenda institucionit? (Hapësiraqë mundëson punën individuale, bisedat/bashkëbisedimet konfidenciale, punën në grup etj.)




16. A është i mjaftueshëm numri i automjeteve zyrtare në kuadër të institucionit?




17. A ekziston në komunë ndonjë sistem, i cili mundëson grumbullimin dhe menaxhimin e informacionit në lidhje me dokumentacionin, procedurat dhe të dhënat në përgjithësi (informacionin e nevojshëm, të dhënat historike, procedurat, etj.)?




18. Nëse po, cila është frekuenca e përdorimit të sistemit të menaxhimit të njohurive nga personeli?




19. Si bëhet vlerësimi i performancës (vlerësimi vjetor dhe 6 mujor i punës së punonjësve)?




20. A bëhet vlerësimi vjetor i punonjësve?




21. A është procesi i rekrutimit të personelit në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin për Shërbimin Civil (LSHC)?




22. Si do t'i vlerësonit shkathtësitë e personelit në drejtorinë tuaj?




23. Si do ta vlerësonit nivelin e pavarësisë së personelit nga menaxheri i drejtpërdrejtë?




24. A është miratuar rregullorja e punës për institucionet arsimore?




24a. Cili është niveli i mbikëqyrjes së zbatimit të rregullores?




25. A është miratuar Kodi i Sjelljes dhe masat disiplinore për nxënësit e shkollave të mesme?




25a. Cili është niveli i mbikëqyrjes së zbatimit të Kodit të Sjelljes?




26. A mund të na tregoni sa të informuar jeni për rregulloren 21/2013 për parandalimin dhe referimin e dhunës në arsimin parauniversitar?




27. A ka caktuar komuna zona të mbulimit nga shkolla?




28. Cili është niveli i mirëmbajtjes dhe riparimit në ndërtesat shkollore?




29. A ofron komuna transport për nxënësit e shkollave të mesme dhe mësuesit që jetojnë më shumë se 4 kilometra larg shkollës?




30. A ofron komuna arsim special në bazë të ligjit?




31. A ka zbatuar Komuna udhëzimin administrativ (DKA 19/2012) për krijimin e ekipeve për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkolla?




32. A ka caktuar komuna zona të mbulimit nga niveli para-shkollor?




33. A ka institucione para-shkollore në komunë?




34. A ka zyrtarë në komunë që mbulojnë arsimin para-shkollor?




35. Në çfarë niveli e njeh dhe e promovon komuniteti rëndësinë e zhvillimit të fëmijërisë së hershme?



36. Cili është niveli i mirëmbajtjes dhe riparimit në ndërtesat e arsimit para-shkollor?




37. A promovon komuna politika dhe objektiva për ruajtjen e shëndetit publik në institucionet para-shkollore?




- Jo, komuna nuk promovon politikat dhe objektivat e lidhura me shëndetin në institucionet para-shkollore
- Komuna me raste promovon politikat dhe objektivat e lidhura me shëndetin në institucionet para-shkollore
- Komuna rregullisht promovon politikat dhe objektivat e lidhura me shëndetin në institucionet para-shkollore
- Nuk e di/Pa përgjigje


38. A është i mjaftueshëm numri i mësimitdhënësve të kualifikuar?




39. Cili është niveli i kualifikimit të mësimeve në komunë?




40. A i njohin mësuesit trendet në zhvillimin e politikave të arsimit (legjislacioni, dokumentet e kurrikulës, etj.)?




41. A është punësimi i mësimeve në përputhje me nivelin e tyre të kualifikimit dhe përvojën e kërkuar për lëndët relevante?




42. Kakvi su rezultati maturskih testova i državnih ispita u vašoj opštini?




43. A ka komuna plane vjetore për kulturën, rininë dhe sportin?




44. Cili është niveli i kapaciteteve për formulimin/hartimin e planeve kulturore dhe rinore?




45. A ka qendra kulturore, rinore dhe sportive në komunën tuaj?




45a. Nëse po, cili është niveli i mirëmbajtjes së tyre?




46. Sa shpesh organizohen aktivitete kulturore?




47. Si do ta vlerësonit mbështetjen financiare për aktivitetet për të rinjtë, kulturën dhe sportive?




48. Sa përkrahen aktivitetet kulturore nga donatorët?"




49. A ka komuna juaj dëshmi për tokën bujqësore?




50. A ka një plan komunal për ruajtjen dhe mbrojtjen e tokës?"




51. A ka komuna një rregullore të përcaktuar qartë për dhënien me qira të tokës bujqësore?




52. A ndryshohet destinacioni i tokës sipas një baze ligjore?




53. Cili është niveli i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse (Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor etj.)?




54. A ka komuna kapacitete për hartimin e strategjive për zhvillimin ekonomik lokal?




55. A ka një strategji për zhvillimin ekonomik lokal?




56. A ka komuna një nismë për të krijuar një zonë ekonomike?




57. A ka komuna kapacitete për hartimin e planeve të zhvillimit të turizmit?




58. A ka një plan strategjik të zhvillimit komunal?




59. A ka komuna një qendër turizmi promovuese dhe informative?




60. A janë identifikuar lokacionet me interes turistik dhe kulturor?




60a. Si do ta vlerësonit kujdesin institucional për lokacionet me interes turistik dhe kulturor?




61. Cili ishte niveli i investimeve komunale në infrastrukturën fizike në lidhje me mbështetjen e turizmit?




62. Deri në çfarë mase zbatohet Ligji për Financat e Pushtetit Lokal?




63. Çfarë lloj shkathtësish dhe përvojash ka komuna për zbatimin e ligjit për financat vendore?




64. Çfarë niveli njohurish / shkathtësish ka komuna për të përgatitur kornizën afatmesme buxhetore (KAB)?




65. Sa e njohur është Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) në komunë?




66. Cilat drejtori janë të përfshira në planifikimin e buxhetit?




68. Çfarë aftësisht dhe përvojash ka komuna për planifikimin e buxhetit dhe hartimin e qarkores së buxhetit?




69. A ka ndonjë mekanizëm për identifikimin dhe përzgjedhjen e projekteve?




70. Si do t'i vlerësonit kriteret e përzgjedhjes të projekteve?




71. Cilat janë shkathtësitë dhe përvojat me përgatitjen e projekteve?




72. A është kontrolli i brendshëm i financave publike në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e Thesarit?




73. A përdoren fondet në mënyrë të përshtatshme?




74. A ka mekanizma për kontrollin e brendshëm të financave publike?




75. A ka komuna rregullore për tarifat, pagesat dhe gjjobat?




76. Cili është niveli i mbledhjes së të hyrave vetanake?




77. Cilat janë aftësitë e komunës që sigurojnë të hyrat vetanake?




78. A rishikohet çdo vit rregullorja e tarifave për gjokat dhe penalitetet, dhe a dorëzohet gjithmonë për vlerësimin e ligjshmërisë në MAPL?




79. Çfarë nivel të kapaciteteve ka komuna për auditimin e brendshëm?




80. A ka komuna plane të auditimit?




81. A ka pavarësi profesionale Auditori i Brendshëm?




82. Çfarë nivel të kapaciteteve ka komuna që të sigurojë zbatimin e parimeve etike dhe të kodit të sjelljes nga ekipi i prokurimit?




83. Si do ta vlerësonit koordinimin me nivelin qendror?



84. A ka komuna plane të prokurimit?




85. Nëse po, cili është niveli i kapaciteteve të komunës për përpilimin dhe zbatimin me saktësi të planeve të prokurimit?




■ Kapacitete të ulëta ■ Kapacitete të nivelit të mesëm ■ Kapacitete të nivelit të lartë

86. A ka qendra kryesore të mjekësisë familjare në komunën tuaj (QKMF)?




■ Jo, nuk ka
 ■ Po, por nuk ofron shërbime të plota mjekësore
 ■ Po, dhe ka objekte të mjaftueshme themelore dhe pajisje teknike për të ofruar shërbime
 ■ Po, dhe ka pajisje moderne dhe pajisje teknike për të ofruar shërbime me cilësi të lartë

87. A ka Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në komunën tuaj?




■ Jo
 ■ Po, por kanë shumë probleme në ofrimin e shërbimeve shëndetësore
 ■ Po, dhe ofrojnë shërbime të rregullta shëndetësore
 ■ Po, dhe ofrojnë shërbime shëndetësore me cilësi të lartë


88. A ofron komuna shërbime sociale dhe familjare?




89. Cili është niveli i bashkëpunimit me OJQ-të në terren?




90. A ofron komuna shërbime sociale shtesë, bazuar në nevojat e reja?




91. A e ka komuna përfaqësuesin e vet në bordin e Institutit të Politikave Sociale?




92. A ka komuna informacion rreth institucioneve shëndetësore private?




93. A jep komuna miratim paraprak të institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor?




94. A ka komuna komision inspektimi të institucioneve shëndetësore private?




95. A ka komuna mekanizma që sigurojnë bashkëpunimin me ministrinë në këtë fushë?




96. A ka numër të mjaftueshëm të personelit shëndetësor?




97. A ka komuna politika stimuluese për personelin e tyre shëndetësor dhe specializimin e tyre?




98. A menaxhohen furnizimi me ujë, kanalizimet dhe mbeturinat nga ndërmarrjet publike në komunën tuaj?




99. A ka mekanizma për matjen e cilësisë së shërbimeve në komunë?




100. A ka kryer komuna inspektim sanitar si kontrollore e cilësisë për këto shërbime?




101. A funksionon Njësia e Menaxhimit të Shërbimeve Zjarrfikëse në komunën tuaj




102. A ka një brigadë me numër të duhur të zjarrfikësve në pajtim me ligjin?




103. A ka ndonjë plan për reagim ndaj emergjencave dhe mbrojtjes nga zjarri?




104. Cili është niveli i ekspertizës së komunës për të zhvilluar në detaje një plan realist dhe konkret për të reaguar ndaj emergjencave dhe mbrojtjes nga zjarri?




105. A ka përdorim efikas të burimeve në reagime emergjente?




107. A ka një Komisioni Komunal të Aksionarëve në komunë?




108. A ka një Bord të Drejtorëve?




109. A është miratuar plani i biznesit për ndërmarrjet e pavarura komunale (NPK) nga bordi i drejtorëve?




110. A është themeluar Komisioni i Auditimit?




111. A janë emëruar zyrtarët afaristë të ndërmarrjeve të pavarura komunale (NPK) nga bordi i drejtorëve??




112. A është miratuar kodi etik i ndërmarrjeve të pavarura komunale (NPK)?




113. A ka komuna një plan të qartë për rregullimin e transportit publik?




114. Cilat janë kapacitetet e burimeve njerëzore për të hartuar politika për transportin lokal?




115. A janë të licencuara kompanitë që kryejnë transportin?




116. A respektohet orari i linjave?




117. Cili është niveli i mirëmbajtjes së rrugëve lokale dhe hapësirave publike?




118. A ka komuna një sistem të qëndrueshëm për të monitoruar dhe vlerësuar mirëmbajtjen e rrugëve dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike?




119. A e mat komuna opinionin publik të lidhur me prioritetet për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe hapësirave publike?




120. Cili është niveli i ekspertizës në kuadër komunës në lidhje me hartimin e planit të zhvillimit?




121. Në mungesë të ekspertizës së mjaftueshme, a ka kontraktuar komuna një kompani projektuese për përgatitjen e planit?




122. Deri në çfarë mase bazohen vendimet ekzekutive në planin zhvillimor komunal?




123. Cili është niveli i ekspertizës në kuadër të komunës për përpilimin e hartave të zonimit?




124. Në mungesë të ekspertizës së mjaftueshme, a ka kontraktuar komuna një kompani projektuese për përgatitjen e planit?



125. Deri në çfarë mase bazohen vendimet ekzekutive në planin zhvillimor urbanistik?




126. A ka rregullore apo standarde në përdorim që rregullojnë kontrollin e ndërtimit?




- Jo, komuna nuk ka rregulla ose standarde të zbatuara [Shko tek pyetja 128]
- Po, ka, por nuk respektohen plotësisht
- Po, respektohen, por jo gjithmonë në pajtueshmëri me legjislacionin
- Po, respektohen plotësisht në pajtueshmëri me legjislacionin


127. Sa kuptimplotë është zbatimi i tyre në vendimmarrjen ekzekutive?




128. A janë përcaktuar qartë mekanizmat ligjorë për zbatimin e rregulloreve dhe standardeve të ndërtimit?




129. Sa të mjaftueshme janë burimet njerëzore për zbatimin e rregulloreve dhe standardeve të ndërtimit?




130. A ka komuna plane për mbrojtjen e mjedisit?




131. Cili është niveli i ekspertizës në kuadër të komunës për zhvillimin e planeve për mbrojtjen e mjedisit?




132. Deri në çfarë mase bazohen vendimet ekzekutive në planet për mbrojtjen e mjedisit?




133. A ka një regjistër të pronës publike komunale?




134. A ka komuna një sistem për menaxhimin e pronës publike komunale?




135. Sa e informuar është komuna për miratimin e paketës ligjore për të drejtat e njeriut: Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi Nr. 05/L-021, Ligji për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019?




136. A ka komuna një sistem të qartë për informimin e qytetarëve të saj në lidhje me miratimet/ndryshimet në legjislacion?




137. A e ka themeluar Komuna Zyrën për Komunitete dhe Kthim?




138. A kanë plan pune strukturat komunale për Komunitete dhe Kthim?




139. Sa të qarta janë përgjegjësitë, funksionet dhe raportimi i tyre?




140. Cila është shkalla e bashkëpunimit ndër-sektorial?




141. A ka një mekanizëm të qartë për vendimmarrje për çështjet e pakicave?




142. A është procesi i vendimmarrjes në pajtueshmëri me legjislacionin?




143. Cili është niveli i informacionit të publikut mbi kthimin dhe të drejtat e komuniteteve?




144. A përkthehen dokumentet zyrtare që lëshohen nga komuna?



145. A e ka miratuar komuna rregulloren për përdorimin e gjuhëve?




146. A ka zyrtarë që merren me koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me integrimin evropian në nivel komunal?




- Nuk ka zyrtarë për të koordinuar procesin e integritimit evropian në nivel komunal
- Nuk ka zyrtarë të mjaftueshëm për të koordinuar procesin e integritimit evropian në nivel komunal
- Ka zyrtarë të mjaftueshëm për të koordinuar procesin e integritimit evropian në nivel komunal
- Koordinimi i procesit të integritimit evropian në nivel komunal realizohet plotësisht duke siguruar përmbushjen e të gjitha detyrimeve komunale
- Zyrtarët janë të nivelit më të lartë për të koordinuar procesin e integritimit evropian në nivel komunal

147. Sa përpjekje janë bërë në drejtim të koordinimit të procesit për zhvillimin e kornizës rregullore dhe pjesëmarrjes në përcaktimin e prioriteteve drejt integritimit evropian?




- Asnjë përpjekje në drejtim të koordinimit të procesit për zhvillimin e kornizës rregullore dhe përcaktimin e prioriteteve komunale
- Përpjekje të pamjaftueshme në drejtim të koordinimit të procesit për zhvillimin e kornizës rregullore dhe përcaktimin e prioriteteve komunale
- Përpjekje të mjaftueshme në drejtim të koordinimit të procesit për zhvillimin e kornizës rregullore dhe përcaktimin e prioriteteve komunale
- Koordinimi i procesit për zhvillimin e kornizës rregullore dhe vendosja e prioriteteve komunale është duke u realizuar plotësisht

148. A ka zyrtarë që bëjnë monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të rregullt të dokumenteve strategjike dhe prioriteteve komunale?




- Nuk ka zyrtarë që bëjnë monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të rregullt të dokumenteve strategjike dhe prioriteteve komunale
- Nuk ka zyrtarë të mjaftueshëm që bëjnë monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të rregullt të dokumenteve strategjike dhe prioriteteve komunale
- Ka zyrtarë të mjaftueshëm që bëjnë monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të rregullt të dokumenteve strategjike dhe prioriteteve komunale
- Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i zbatimit të rregullt të dokumenteve strategjike dhe prioriteteve komunale është duke u realizuar plotësisht

149. A ka koordinim dhe bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe donatorët, shoqërinë civile dhe publikun?




- Nuk ka koordinim dhe bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe donatorët, shoqërinë civile dhe publikun
- Koordinimi me organizatat ndërkombëtare dhe donatorët, shoqërinë civile dhe publikun është i ulët
- Koordinimi me organizatat ndërkombëtare dhe donatorët, shoqërinë civile dhe publikun është i rregullt
- Koordinimi me organizatat ndërkombëtare dhe donatorët, shoqërinë civile dhe publikun është në nivelin më të lartë

150. A ka koordinim dhe bashkëpunim mes ZKIE (Zyra Komunale për Integrim Evropian), MAPL dhe MIE për paraqitjen e sfidave, nevojave dhe prioritetëve, dhe për raportimin e rezultateve të arritura nga komuna?




- Nuk ka koordinim dhe bashkëpunim në këto fusha ndërmjet ZKIE në njërin anë dhe MAPL dhe MIE në anën tjetër
- Ka koordinim dhe bashkëpunim mes ZKIE, MAPL dhe MIE
- Ka koordinim dhe bashkëpunim të mjaftueshëm mes ZKIE, MAPL dhe MIE
- Koordinimi dhe bashkëpunimi mes ZKIE, MAPL dhe MIE është në nivelin më të lartë

151. A ofrohet ndihmë dhe këshillim ligjor për komunën dhe Komisionet e Kuvendit Komunal me qëllim të pasqyrimin të Acquis dhe politikave përkatëse të BE-së në zhvillimin e kornizës rregulatore të komunës?




- Nuk ka asnjë mbështetje dhe këshilla ligjore dhe shërbime
- Ka ofrim të përkohshëm të ndihmës dhe këshillave ligjore dhe shërbimeve
- Ka ofrim të rregullt të mbështetjes dhe këshillave ligjore dhe shërbimeve
- Ofrimi i mbështetjes dhe këshillave ligjore dhe shërbimeve bëhet në mënyrë profesionale

152. A ka koordinim dhe bashkëpunim në komunë mes Zyrës së Personelit dhe Zyrës për Komunikim dhe Informim në ngritjen e kapaciteteve të personelit të komunës dhe në komunikimin dhe informacionin në lidhje me Integrimin Evropian?




- Nuk ka koordinim dhe komunikim në komunë mes Zyrës së Personelit dhe Zyrës për Komunikim dhe Informim Publik
- Ka koordinim dhe komunikim në komunë mes Zyrës së Personelit dhe Zyrës për Komunikim dhe Informim Publik
- Ky koordinim dhe bashkëpunim është i ulët / Ka mungesë të një agjende të përcaktuar, të qartë dhe konkrete
- Ky koordinim dhe bashkëpunim është i mjaftueshëm / Takimet do të mbahen në bazë të agjendës
- Ka koordinim të plotë dhe të vazhdueshëm dhe bashkëpunim në komunë mes Zyrës së Personelit dhe Zyrës për Komunikim dhe Informim Publik / Ky koordinim dhe bashkëpunim është në nivelin më të lartë / Takimet do të mbahen në bazë të agjendës dhe sipas nevojës kur kërkohet

153. A ka komuna zyrtarë të ZKIE-s që njohin gjuhë të huaja?



154. Deri në çfarë mase janë trajnuar zyrtarët e rinj në fushën e integrimit evropian?



155. A ka pasur një shkëmbim të përvojave me vendet që janë anëtarësuar në BE?

